

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI: MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME  
SPECIALIZIM NË TEKNOLOGJI DHE TIK**



**TEZA MASTER**

**Efekti i punës në grupe në ngritjen e cilësisë së  
mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë**

**Mentori:**

Prof.Ass.Dr. Sylejman Berisha

**Kandidati:**

Liridone Zatriqi

*Prishtinë, Shkurt 2022*



© 2022 – *Liridone Zatriqi*  
Të gjitha të drejtat të rezervuara.

## ABSTRAKTI

*Shkolla bashkëkohore synon të rrisë përvojën dhe aftësitë e nxënësit duke i stimuluar ata për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, ku nxënësit shohin dhe praktikojnë ato metoda për një mësim më efektiv.*

*Mësimdhënia dhe të nxënit janë procese mjaft komplekse, mirëpo për t'u realizuar në mënyrë sa më të suksesshme duhet që të zbatohen disa komponentë të cilët janë të një rëndësie të veçantë dhe janë çelësi i suksesit. Në mesin e komponentëve vend me rëndësi mund të zënë metodat, teknikat dhe posaçërisht format e punës me grupe e cila është rruga përmes së cilës arrijmë qëllimet tona në procesin e të nxënit. Puna me grupe nuk janë praktikat e vetme universale për të mësuar, ato janë thjeshtë një mënyrë në të cilën mund të angazhohen nxënësit për formimin e njohurive të reja.*

*Zgjedhja e mjeteve të duhura është e rëndësishme për një bashkëpunim për mësim efektiv. Këto mjete të bashkëpunimit duhet të kenë funksionalitet të drejtë dhe duhet të jenë të lehta për t'u përdorur, vetëm atëherë nxënësit do të ndjehen të sigurt dhe të kënaqur në kryerjen e detyrave të tyre. Fokusi i tyre do të përmirësohet në mësim dhe ata do të ishin në gjendje të përfundonin mësimin e tyre mjaft shpejt dhe me sukses.*

*Qëllimi i këtij hulumtimi pra është qasja e metodave të përshtatshme për nxënien më të lehtë për nxënësit andaj dizajnimi i këtij hulumtimi është kuazi eksperimental, me metoda të përziera (sasiore dhe cilësore) dhe është realizuar me tri klasë të shtata në shkollën fillore të mesme të ulët "Abdullah Shabani" në Mitrovicë (si mostra të qëllimshme), ku njëra klasë kishte rolin e grupit eksperimental kurse dy të tjetra kishin rolin e grupit të kontrollit. Si instrumente të mbledhjes së të dhënave kemi përdorur dy teste (paratesti, pastesti), një pyetësor me nxënës dhe një pyetësor për mësimdhënësit.*

*Me anë të të dhënave të fituara përmes pyetësorëve kemi arritur të fitojmë rezultate të cilat kanë sjellur rezultate pozitive për një nxënie efektive.*

**Fjalët kyçe:** *Mësimnxënia, puna në grupe, raportet nxënës-nxënës, nxënësi në qendër të vëmendjes, mësim efektiv, rezultat e të nxënit etj.*

## ABSTRACT

*Contemporary school aims to enhance students' experience and skills by stimulating them to performing various activities, where students see and practice those methods for a more effective learning.*

*Teaching and learning are quite complex processes, but to be realized in a way the most successful must be implemented some components which are of particular importance and are the key to success. Among the components, methods and techniques can occupy an important place and especially the forms of group work which is the way through which we achieve our goals in the learning process. Group work is not the only universal practice to learn are simply a way in which students can engage in the formation of new knowledge*

*Choosing the right tools is important for an effective learning collaboration. These collaboration tools should have the right functionality and should be easy to access used, only then will students feel confident and satisfied in performing the tasks tire. Their focus would be improved on learning and they would be able to finish learning them fairly quickly and successfully.*

*The purpose of this research is to approach the appropriate methods for easier learning for students so the design of this research is an experimental quasi, with mixed methods (quantitative and qualitative) and was realized with three seventh grades in the primary and lower secondary school "Abdullah Shabani" in Mitrovica (as intentional samples), where one class had the role of experimental group and the other two had the role of group control. As data collection tools we used two tests (pre-test, pastest), a questionnaire with students and a questionnaire for teachers.*

*Through the data obtained through questionnaires we have managed to obtain results which have brought positive results for an effective learning.*

**Keywords:** *Learning, group work, student-student relationships, student-centered attention, effective learning, learning outcome etc.*

## FALËNDERIMI

Gjatë mbarështimit të këtij punimi jam ballafaquar me mjaft vështirësi dhe sfida të ndryshme, mirëpo, duke pasur vazhdimisht mbështetjen e disa individëve, besoj, ia kam dalë ta përmbyll ashtu si duhet. Për rrjedhojë, do ta kufizoj vetëm me falënderimet e disa personave, të cilët më ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia, të cilëve do të doja t'ju shprehja mirënjohjen më të sinqertë nga shpirti e zemra.

Një falënderim i veçantë shkon për udhëheqësin tim, mentorin Prof. Ass. Dr. Sylejman Berisha, për ndihmën, mbështetjen që më ofroi gjatë gjithë punës sime, pra për kontributin e tij në finalizimin e punimit tim të diplomës.

Në fund gjithashtu do të dëshiroja t'i shpreh një mirënjohje të thellë familjes sime. Asaj i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të rrugëtimit tim në jetë. Për këtë mbështetje të vazhdueshme materiale e morale që ma kanë bërë familja ime, jam përpjekur që t'ua shpaguaj me punën e rezultatet e mia, në mënyrë që, së paku, t'i bëj të ndihen krenarë me mua.

# PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI.....	iii
ABSTRACT .....	iv
FALËNDERIMI .....	v
Lista e tabelave .....	ix
Lista e grafikëve .....	ix
1. HYRJE.....	1
1.1. Qëllimi i hulumtimit .....	1
1.2. Pyetjet e hulumtimit.....	2
1.3. Hipotezat e hulumtimit .....	2
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	3
2.1. Historiku i mësimit në grupe.....	4
2.1.1. Perspektiva e teorive për të mësuarit bashkëpunues.....	6
2.1.2. Mësimdhënia bashkëkohore si proces përmes të cilit fitohet dituria, vlerat, qëndrimet dhe shkathtësit e nxënësit.....	10
2.3.1. Madhësia dhe përbërja e grupit.....	15
2.3.2. Role të mundshme të nxënësve në grupet e të nxënësve .....	18
2.3.3. Nxitja e punës në grupe dhe efekti i saj te nxënësit .....	20
2.3.4. Karakteristikat e punës në grupe.....	21
2.3.5. Mekanizmat e punës në grup .....	22
2.3.6. Anët pozitive të të mësuarit në grupe.....	23
2.3.7. Anët negative të mësimit në grup .....	25
2.4. Arsyet dhe rëndësia e përdorimit të teknologjisë në klasë .....	28
2.5. Teknologjia dhe qasja konstruktiviste e saj.....	29
2.5.1. Përdorimi i teknologjisë së komunikimit si mjet mësimor.....	31
2.5.2. Zhvillimi i orës së mësimit duke përdorur teknologjinë .....	33

2.5.3. Përmbajtja mësimore/akademike .....	33
2.5.4. Rezultatet e të nxënit, metodologjia dhe procedurat në lëndën e teknologjisë .....	34
2.5.5. Vlerësimi i të nxënit .....	35
2.6. Kompetencat e mësuesit për realizimin e situatave të të nxënit me bazë teknologjinë në orën mësimore.....	36
2.6.1. Planifikimi i një situatë të nxëni duke përdorur TIK-un .....	37
2.6.2. Struktura e një matrice të situatës së të nxënit me bazë TIK-un.....	38
2.6.3. Format i situatës së të nxënit .....	40
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	41
3.1. Mostra.....	41
3.2. Instrumentet .....	41
3.3. Procedurat.....	42
3.4. Rezultatet e pritura nga hulumtimi .....	42
IV. REZULTATET E HULUMTIMIT.....	43
4. Përpunimi dhe analiza statistikore e të dhënave .....	43
4.1. Paratesti i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3.....	43
4.2. Pastesti i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3 .....	46
4.3. Rezultatet e pyetësorit i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3 .....	49
4.4. Rezultati i pyetësorit drejtuar mësuesve për rastin e hulumtimit.....	55
V. ANALIZA DHE DISKUTIMI I TË DHËNAVE .....	60
VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	62
6.1. Përfundime nga hulumtimet .....	62
6.2. Përfundimet lidhur me efektin e punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në shkollën e mesme të ulët “Abdullah Shabani” .....	62
6.3. Përfundime lidhur me kontributet e implementimeve të efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë .....	62
6.4. Përfundimet në lidhje me paratestin dhe pastestin me nxënësit e klasave VII/2 dhe VII/3 .....	63



6.5. Përfundimet në lidhje me pytësoret për nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3 .	63
6.6. Përfundimet në lidhje me pytësoret për mësimdhënës .....	63
6.7. Rekomandime.....	64
VII. BIOGRAFIA .....	65
7.1. SHTOJCA A: Paratesti i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3 ..	69
7.2. SHTOJCA B: Pastesti i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3.....	71
7.3. SHTOJCA C: PYETËSORI PËR NXËNËS TË KLASAVE VII/1, VII/2 dhe VII/3 .....	73
7.4. SHTOJCA D: PYTËSORI PËR MËSIMDHËNËS TË KLASAVE VII/1, VII/2 dhe VII/3.....	75

## Lista e tabelave

Tabela 1. Matrica e situatës së të nxënit me bazë Tik-un .....	38
Tabela 2. Rezultati i paratestit .....	60
Tabela 3. Rezultati i pastestit.....	60
Tabela 4. Krahasimi i rezultateve .....	61

## Lista e grafikëve

Grafiku 1. Sukses i përgjithshëm i paratestit të paraleles VII-1 .....	43
Grafiku 2. Sukses i përgjithshëm i paratestit të paraleles VII-2.....	44
Grafiku 3. Sukses i përgjithshëm i paratestit të paraleles VII/3 .....	45
Grafiku 4. Sukses i përgjithshëm i pastestit të paraleles VII/2.....	46
Grafiku 5. Sukses i përgjithshëm i pastestit të paraleles VII/3.....	47
Grafiku 6. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 1 .....	49
Grafiku 7. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 2.....	50
Grafikoni 8. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 3.....	50
Grafikoni 9. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 4.....	51
Grafiku 10. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 5.....	51
Grafikoni 11. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 6.....	52
Figura 12. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 7.....	52
Grafikoni 13. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 8.....	53
Grafikoni 14. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 9.....	53
Grafikoni 15. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 10.....	54
Grafikoni 16. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 1.....	55
Grafikoni 17. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 2.....	55

Grafikoni 18. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 3.....	56
Grafikoni 19. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 4.....	56
Grafikoni 20. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 5.....	57
Grafikoni 21. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 6.....	57
Grafikoni 22. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 7.....	58
Grafikoni 23. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 8.....	58
Grafikoni 24. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 9.....	59
Grafikoni 25. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 10.....	59

## 1. HYRJE

Sot, Kosova synon të ngrihet në nivelin e standardeve evropiane andaj ka azhuruar kurrikulat më përmbajtje të reja, metoda e materiale mësimore dhe metoda të reja të vlerësimit që kanë të bëjnë me arritjen e standardeve arsimore.

Sistemi arsimor modern, synon t'i vendos nxënësit në qendër të orës mësimore, së bashku me interesat e tyre. Këta nxënës kanë nevojë për bashkëveprim me mësimdhënësin e lëndës dhe përmbajtjen mësimore si dhe punën me grupe me një bashkëpunim me njëri-tjetrin gjatë procesit të të mësuarit, kështu duke pretenduar rezultate më të mira.

Ndryshimet që kanë ndodhur në fushën e arsimit, veçanërisht të nxënësve ndërmjet punës në grupe ka karakteristikat thelbësore se i ndihmon nxënësit që të shkëmbejnë pikëpamjet, shprehin ide, komunikojnë lirshëm dhe diskutojnë në njësi grupesh të vogla, kështu nxënësit gjatë orës mësimore kanë mundësi të bashkëveprojnë me prezantimet interaktive duke përdorur teknika më të lehta ku mund të gjejnë vetën e tyre në mënyrë të japin përgjigje dhe të jenë të qasur për të arritur njohuri.

Për të analizuar produktivitetin e përfitimit të njohurive të nxënësit në lëndën e teknologjisë, ky studim tenton të ndriçojë problematikën e punës në grupe duke shqyrtuar mënyrën e organizimit dhe planifikimin e orës mësimore, përdorimin e strategjive dhe teknikave të ndryshme të cilat nxitin mësimin të nxënësit si dhe për të bashkëpunuar gjatë procesit mësimor, poashtu faktorë kryesor është edhe përgatitja profesionale e mësimdhënësve kështu duke synuar realizimin e sukseshëm të orës mësimore në grupe.

Në metodologjinë e sotme të bashkëpunimit mësimdhënës-nxënës synohet një pjesëmarrje më aktive e nxënësve në punën në grupe pasi vetë procesi i mësimdhënies ka në qendër nxënësin, prandaj kjo kërkon planifikim të mirëfilltë të metodologjisë mësimore dhe teknikave që do të përdoren për të arritur objektivat e planit mësimor mësimdhënie-mësimnxënie me anën e rritjes së efektivitetit.

### 1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është i bazuar në zhvillimin dhe vetëdijësimin e përdorimit të formave të ndryshme gjatë procesit mësimor, ku ky zhvillim është më se i domosdoshëm edhe në ndryshimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Mësimdhënia bashkëkohore dhe të nxënit kërkon organizim më fleksibil të punës në shkollë, kërkon planifikim të mirëfilltë të materialit mësimor, metodologjisë mësimore dhe teknikave që do të përdoren për të arritur objektivat mësimore dhe synimet e shoqërisë.

Pra, qëllimi kryesor është arritja dhe suksesi i lartë në mësimnxënie duke përdorur format e punës në grupe ku duke rezultuar në suksese të knaqshme kjo formë e të mësuarit mund të iu shërbejë secilës shkollë dhe se një gjë e tillë është e mundshme dhe shumë efektive.

## **1.2. Pyetjet e hulumtimit**

Në kuadër të punimit të magistraturës, konform realizimit të hulumtimit kam adresuar hipotezat vijuese:

Pyetja kryesore në të cilën e kam bazuar hulumtimin tim është:

- Sa ka efekt puna në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lënden e Teknologjisë?

Pyetja ndihmëse që e përcakton edhe më tutje bazën e hulumtimit është:

- Sa realizohet forma e punës në grupe gjatë procesit mësimor?
- Sa janë nxënësit bashkëpunues gjatë punës në grupe?

## **1.3. Hipotezat e hulumtimit**

- Puna në grupe ka efekte pozitive në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lënden e Teknologjisë.

Hipoteza ndihmëse :

- Nxënësit janë bashkëpunues gjatë punës në grupe.

## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në zhvillimet e përgjithshme shoqërore, politike, ekonomike, shkencore e teknologjike, është më se e domosdoshme edhe ndryshimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shkolla duhet të jetë në hap me këto ndryshime, përndryshe nuk do të mund ta luaj rolin dhe funksionin e saj edukativoarsimor. Në teorinë pedagogjike janë të njohura disa prej tyre, përdorimi i të cilave ndikon në planifikimin dhe organizimin e mësimdhënies bashkëkohore (Babaj, 2021).

Mbështetur në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (MASHT, 2013), sektori i arsimit është i orientuar kah përmirësimi i cilësisë së arsimit, që nënkupton ndryshime të konsiderueshme dhe sfiduese për implementimin e kurrikulave shkollore bazuar në kompetenca. Në këtë drejtim Korniza Kurrikulare e Kosovës fokusohet në vënien e nxënësit në qendër (MASHT, 2016).

Ndërsa bazuar në raportin e punës 2010 (KEC, 2011), organizimi i mësimit ndërmjet teknikave, metodave e strategjive solli freski dhe kreativitet në punën e mësimdhënësve e cila rezultoi me sukses në metodat e ndryshme duke përmenduar edhe metodën e punës në grupe (Avdiu, 2013). Përveç interesave të nxënësve, në motivimin për punën në grupe theksojmë edhe rolin e mësimdhënësit si model motivimi (Gjinaj, 2018). Një nga faktorët kryesor në motivimin e nxënësve për të nxën mësimin e caktuar është edhe mësimdhënësi i cili vlerëson të menduarit e secilit nxënës kështu duke e bërë edhe diskutimin më të gjerë ku secili nxënës mund të jetë i lirë në shprehje dhe është entuziast për të ndarë dashurinë njohurit që ai posedon, pra ky punim fokusohet tek metodat dhe teknikat me në qendër nxënësin duke rezultuar pozitiv në efektin e mësimnxënies (Gjokutaj, 2009).

Kohëve të fundit janë bërë mjaft hulumtime në lidhje me rolin dhe mundësitë e mësimdhënësve për të krijuar orë mësimore atraktive dhe zbavitëse dhe për shumëllojshmërinë e metodave që mund të përdoren për këtë qëllim (Gixhari, 2016).

Në këtë kontekst, edhe hulumtimin tonë e kemi përqendruar në përcaktimin e efikasitetit të këtyre platformave në procesin mësimor, ku mësimdhënësi do të përdorë gjatë mësimdhënies metodat novatore, më parë ai duhet të jetë i trajnuar rreth metodës, ta ketë përvetësuar dhe të ketë njohuri shumë të mira rreth saj e më pas ai do të jetë trajnuar për nxënësit, andaj shqyrtimi i hulumtimeve të realizuara dhe gjetjet në këtë aspekt janë mbështetje në punën tonë hulumtuese (Kurti, 2012).

Poashtu në kohët e fundit, hulumtimet e shumta raportojnë angazhimin e madh drejt strategjive të metodave për zhvillimin e mësimit më efektiv duke synuar ngritjen e cilësisë së nxënies kështu duke munduar tejkalimin e tradicionalës, sepse mësimi është veprimtari shumë e ndërlikuar dhe ndryshimi i metodave mësimore kërkon përvetësimin e vet (Nuredini, 2012).

Ka mendime të shumta se mësimdhënia dhe të nxëniet janë procese mjaft komplekse, mirëpo për t'u realizuar në mënyrë sa më të suksesshme duhet që të zbatohen disa komponentë të cilët janë të një rëndësie të veçantë dhe janë çelësi i suksesit, andaj me mësimdhënie bashkëkohore duhet të kuptojmë atë lloj mësimdhënie, e cila lehtëson me forma, metoda, teknika dhe strategji të përshtatshme në procesin e të nxëniet të nxënësve (Bebaj, 2019).

Puna në grupe ka rol shumë të rëndësishëm në jetë e përgjithshme shoqërore ku nënkupton edhe “angazhimin e pavarur të grupit të nxënësve-studentëve dhe i shërben punës mendore të të gjithë klasës, e cila kërkohet me planin mësimor (Kryeziu, 2012).

I gjithë qëllimi i këtij studimi është ngritja e vetëdijës së mësimdhënies për mësimdhënien e organizuar në atë mënyrë që ngritë cilësinë e nxënies, duke planifikuar orën mësimore me metodologjinë më të përshtatshme dhe më atraktive për nxëniesit, rast konkret metoda e punës në grupe.

## **2.1. Historiku i mësimit në grupe**

Për të njohur më mirë veprimtarinë mësimore në grupe sot, ishte në interesin tonë të kuptojmë zhvillimin historik të saj. Shkolla bashkëkohore aktive krahas shkollës tradicionale, si parim ka aktivizimin dhe stimulimin e nxënësve, pra nisët nga përvoja e nxënësve i stimulon për “aktivitete praktike drejtpërdrejtë me realitetin (puna e tyre në kabinete, puntorin e shkollës) t'i pasurojë dhe t'i zgjerojë ato aktivitete”, (Ibrahimi, 2004).

Zhvillimet e fundit gjatë integrimit të reformës arsimore, si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit, e ndihmuar nga mjete të shumëllojshme të transmetimit dhe të komunikimit kanë bërëtë mundur që mësimdhënia të ndryshojë nga ajo e dhjetëvjeçarëve të mëparshëm, madje duke i paraprirë ndryshimeve që sjellin zhvillim (Musai, 2003).

Studiuesi Dewey si përfaqësues i shkollës protagoniste në SHBA thekson:

*“Në vend të ngarkesës nga jashtë duhet të kultivojmë individualitetin, në vend të disiplinës së imponuar nga jashtë kemi aktivitetet e lira, në vend të nxënies nga tekstet dhe mësuesi kemi nxënie nga përvoja, në vend të shkathtësive të izoluara, të cilat fitohen gjatë stërvitjeve kemi fitimin e shkathtësive dhe të teknikave si mjet për realizimin e qëllimeve jetësore, në vend të njohjes me qëllime statike dhe materialin mësimor ballafaqohemi me botën që ndryshon”.*

Gjatë shqyrtimit të literaturës së studiuesit Zylfiu (2005), kemi hasur në studime të shumta lidhur me hapat e parë të organizimit të punës mësimore në grupe. Sipas tij, organizimi i punës mësimore në grupe ka një histori të gjatë dhe mjaft dinamike dhe është zhvilluar mbi baza të kritikës që i është drejtuar punës frontale dhe kërkesave shoqërore për afirmimin e identitetit social të nxënësit në mësim, në kuadër të grupit punues-mësimor. Mbështetur tek autori Shahini (2013), pas Luftës së Parë Botërore, pedagogët e njohur francez Rozhe Kuzines dhe Peter Peterson në Gjermani filluan ta praktikojnë me të madhe këtë formë të organizimit të punës mësimore (Zylfiu, 2005).

Këto studime, gjithashtu tregojnë se produktet e para të punës mësimore në grupe në fillim të këtij shekulli, në të njëjtën kohë, vihen në dukje në Francë dhe në Gjermani, duke reflektuar ngritjen e aktivitetit, interesimin e nxënësve dhe disiplinën për punë mësimore, zhvillimin e raporteve interpersonale dhe rolin e bashkëpunimit reciprok si dhe veçoritë e tjera pozitive, rezultatet e të cilave u përhapën edhe në viset e tjera të Evropës e në mbarë botën. Hulumtuesit kryesorë të të mësuarit bashkëpunues njihen Robert Slavin, Roger dhe David Johnson si dhe Spancer Kagan, secili prej tyre me qasje pak më ndryshe (Charlotteaux, 2009).

Gjatë shqyrtimit të literaturës, gjejmë se qëndrimet e këtyre shkencëtarëve dhe të shumë të tjerëve në atë kohë ishin drejtuar kundër sistemit tradicional të organizimit të punës mësimore, duke menduar se me këtë risi organizative do të tejkaloheshin dobësitë e shumtatë formave konvencionale të punës mësimore. Studiuesi Spencer Kagan thotë “ne jemi shumë të qartë me mësuesit se të mësuarit në bashkëpunim duhet të jetë pjesë e ndonjë mësimi” (Charlotteaux, 2009).

Për punën mësimore në grupe, tek autori Zylfiu (2005) gjejmë kontributin teorik dhe praktik të pedagogut të njohur frances R. Cousinet, duke përmbledhur aty edhe rezultatet e të tjerëve në këtë drejtim, e sidomos të Djuit dhe Dekrolit (Zylfiu, 2005). Sipas të njëjtit autor, format më të organizuara të punës mësimore në grupe, vihen në dukje rreth viteve 1954-1957, kur mbahen shumë konsulata profesionale dhe shkencore për popullarizimin e kësaj forme për aftësimin profesional të kuadrove mësimore. Për zhvillimin e punës në grupe, idetë më bashkëkohore për këtë formacion social të punës mësimore i ka dhënë edhe August Vitak, profesor në Vjenë, i cili në bazë të punës shumëvjeçare në këtë drejtim konsideron se “puna në grupe i shërben punës mendore të klasës së ndarë në grupe”.

Sipas R. Cousinet (Nuredini, 2012), organizimi i punës në grupe zhvillohet në bazë të parimit të grupit të lirë dhe të zgjedhjes së lirë të punës.



Prandaj, sipas tij në punën grupore nxënësve u mundësohet socializimi i plotë në mësim dhe mundësia për një përgatitje më të mirë për jetën, ku duke shfaqur aspektet intelektuale të angazhimit në punë grupore, nxënësit zbulojnë të vërtetat shkencore, të cilat ndikojnë në formimin e tyre intelektual dhe social. Ndërkaq, studiuesi i njohur August Vitak (Meyer, 2002), krahas formave tjera, rekomandon edhe këtë formacion social të organizimit të punës, për të cilin thotë: “grupi është një formë që ka veti qenësore të një profili të caktuar dhe mundësi të funksionalizimit ndaj individit dhe kolektivit”.

Elementet e para të këtij formacioni të organizimit didaktik të punës mësimore fillojnë të aplikohen te ne që nga periudha midis dy luftërave botërore, posaçërisht arsimi i mesëm, me mundësitë e modaliteteve të shumta të organizimit dhe të aftësisë profesionale, përmbledh në vete forma më bashkëkohore të punës mësimore, pra edhe më kreative të organizimit të punës mësimore në grupe (Zylfiu, 2005).

Duke parë rëndësinë e organizimit të punës në grupe, në kushtet e tanishme të organizimit të procesit mësimor, konsiderohet se ky formacion didaktik i punës duhet të jetë pjesë përbërëse e punës sonë të përditshme, sepse kjo formë ka rëndësi të posaçme, sidomos shikuar nga aspekti social, intelektual dhe moral (Shahini, 2013). Sipas hulumtimeve, të mësuarit bashkëpunues lehtëson shkëmbimin e ideve brenda grupeve, rrit motivimin në mesin e pjesëmarrësve aktiv, nxit të menduarit kritik, nxit shoqërorizimin si dhe përmirëson qëndrimet ndaj mësimin, në këtë rast u mundëson nxënësve të marrin pjesë në diskutime dhe të marrin përgjegjësitë e tyre në mësim.

Krahas R.Kusines, edhe përfaqësuesit e pedagogjisë Austriake (Elsa Kohler e të tjerë) në ishin të matur në vlerësimet e punës në grupe, duke vënë në dukje edhe kërkesat për mundësitë e zgjidhjeve të tjera të punës mësimore (Zylfiu, 2005).

Duke analizuar sukseset në hapat e parë të zhvillimit të punës mësimore në grupe, teoricienët bashkëkohorë këtë formacion e konsiderojnë si risi në ndryshimin e pozitës së nxënësit dhe mësimdhënësit në procesin mësimor dhe si formacion social rekomandohet të jetë pjesë përbërëse e përditshmërisë në shkolla.

### **2.1.1. Perspektiva e teorive për të mësuarit bashkëpunues**

Autorë të shumtë konsiderojnë se interes në të mësuarit në bashkëpunim paraqesin teoritë konstruktiviste, si një qasje apo orientim, e pozicionon të mësuarin si një proces aktiv dhe konstruktiv.

Si një reagim ndaj qasjeve didaktike kuptojmë se konstruktivizmi është më shumë një proces aktiv dhe kontekstual i krijimit të njohurive se sa i përfitimit të tyre. Sipas tij, nxënësit në mënyrë të vazhdueshme i provojnë këto hipoteza përmes marrëdhënieve sociale.

Roli i arsimit, sipas këndvështrimeve konstruktiviste, është t'u tregojë nxënësve, se si të ndërtojnë njohurinë, të promovojnë bashkëpunimin me të tjerët dhe të tregojnë perspektivat e ndryshme që mund të sillen në një problem të veçantë.

Sot zhvillimi i këndvështrimeve konstruktiviste sipas Webb&Palincsar 1966, (Woo, 2011) ka nxitur “një interesim të madh për situatat në të cilat përpunimi, interpretimi, shpjegimi dhe argumentimi janë pjesë integrale në veprimtarinë e grupit dhe në të cilat të nxënësit mbështetet nga individ të tjerë”.

Një prej perspektivave teorike më të spikatura se si nxënësit mund të mësojnë duke ndërvepruar me të tjerët është bazuar në pikëpamjet sociale konstruktiviste të Vigotskit 1978, (Garner & Kaqulich, 2009). Sipas kësaj perspektive, fëmijët mësojnë nga bashkëveprimi me shokët kështu që ata mund të kompletojnë detyrat të cilat nuk mund ti bëjnë vetëm.

Vigotski ishte shumë i interesuar për të nxënësit nën drejtimin e mësimit dhe për çdo përvojë strukturuese që mbështet të nxënësit e një personi tjetër (Woolfolk, 2011). Sipas tij, nxënësit duhet të vendosen në situata ku mund të bëjnë përpjekje për të kuptuar dhe ku nuk do të mungojë mbështetja nga nxënësit e tjerë apo nga mësimit.

Kjo sipas të njëjtit studiues, për faktin se nganjëherë mësimit më i mirë është një nxënës tjetër që sapo ka gjetur mënyrën e zgjedhjes së problemit prandaj vendosja e një nxënësi të mirë me një nxënës jo dhe aq të mirë, është një mënyrë që funksionon sepse nxënësit përfitojnë nga shkëmbimi i shpjegimeve.

Metoda e të mësuarit reciprok, si aplikim bashkëkohor i teorisë së Vigotskit (Shahini, 2013), përdoret me qëllim përmirësimin e aftësive të nxënësve për të mësuar. Sipas kësaj metode, mësimit duhet të mundësojë nxënësve situatat kur ata përpiqen të zgjedhin dilemat, të veprojnë së bashku në përvetësimin e aftësive thelbësore: përmbledhjes, pyetjes, sqarimit dhe parashikimit.

Rrjedhojë e përdorimit të kësaj metode perceptohet që roli i mësimit në proces reduktohet, si rezultat, ata mund të mbajnë mend më mirë konceptet dhe njohuritë që zbuluan vetë, në kundërshtim me modelin e transferimit të njohurive.

Teorit e Vigotskit (Shahini, 2013) mbështesin faktin se mësimit duhet t'u mundësojë nxënësve situata autentike, në të cilat ata duhet të përpiqen për të zgjedhur dilemat që kanë, e kjo ngjet atëherë kur në një mjedis të caktuar shkollor, partnerët social të kenë nivele të ndryshëm zhvillimi, në mënyrë që të veprojnë së bashku në zgjidhjen e problemeve.

Shumë konstruktivistë përkrahin konceptet e Vigotskit se proceset mendore më të larta zhvillohen nëpërmjet negocimit dhe ndërveprimit shoqëror, kështu që në procesin e të nxënës vlerësohet bashkëpunimi (Woolfolk, 2011).

Vigotski, sipas autorit (Shahini, 2013) është relevant ndaj koncepteve të mësimdhënies si "apprenticeship", në të cilat mësimdhënësi apo një nxënës më i avancuar, të punojë në to në mënyrë të suksesshme. Kjo sipas tij, ndihmon të sigurohet që në këtë bashkëpunim të ndërsjellë, ata do të ishin duke vepruar brenda zonës së tyre të zhvillimit të përafërt.

Sipas O'Donnell, 2002/2006 (Woolfolk, 2011) teorit didaktike me këndvështrime mësimore të ndryshme e përkrahin të nxënës bashkëveprues për arsye të ndryshme. Sipas tij, teoricientët e përpunimit të informacionit vënë në dukje vlerën e diskutimit në grup, i cili i ndihmon pjesëmarrësit të praktikojnë, të përpunojnë e të zgjedhin njohurit e tyre. Ndërsa, anëtarët e grupit pyesin dhe shpjegojnë, ata detyrimisht i organizojnë njohurit e tyre. Sipas të njëjtit autor, përkrahësit e këndvështrimit piazhetian shpalosin idetë se ndërveprimet në grup mund të krijojnë konflikt konjitiv dhe mungesë ekuilibri, çka e shpie një individ të vërë në pikëpyetje të kuptuarit e tij dhe të detyrohet të përdorë ide të reja ose, siç ka thënë Piazheja, 1985 (Woolfolk, 2011) "të shkojë përtej gjendjes së tij aktuale dhe të çajë në drejtime të reja".

Ndërsa, përkrahësit e teorisë e Vigotskit shprehin idenë se ndërveprimi shoqëror është i rëndësishëm për procesin e të nxënës, sepse nga "ndërveprimi shoqëror burojnë funksione mendore më të larta, si të arsyetuarit, të kuptuarit e thellë dhe të menduarit kritik, të cilat pastaj përvetësohen nga individët" (Woolfolk, 2011).

Sipas studiuesit Burner (Shahini, 2013) të mësuarit përmes zbulimeve bazohet kur nxënësit zbulojnë vetë faktet dhe mardhëniet mes tyre e kjo ndodh kur nxënësit ndërveprojnë me botën përmes eksplorimit dhe manipulimit të objekteve, duke përdorur pyetjet, debatet, polemikat apo duke bërë eksperimente.

Gjatë vitit 1920, R. Cousinet organizoi dhe eksperimentoi metodën e punës së lirë në grupe në klasa të ndryshme nxënësish nga 9-12 vjeç duke vazhduar edhe për 40 vjet me radhë (Shahini, 2013). Ai në bashkëpunim me Alfred Binet i cili në ato vite ishte mësimdhënësi, fillon të studiojë "fëmijët udhëheqës" në grupe, rolin e tyre në grup, ndryshueshmërinë e lojrave të fëmijëve në funksion të stinës.

Në këto hulumtime, ai thekson:

*"sapo fëmijët i lëmë pak të lirë në organizimin e punës së tyre, vëzhgojmë që në fillim një gjallëri të madhe e të natyreshme. Duhet të formohen grupet dhe kjo ngjet shpejt...Këto grupe formohen sipas simpatisë dhe zakoneve të njëjta brenda klase dhe jasht saj.*

*Dhe më pas kudo ndodhin të njejtat dukuri: fëmijët konstatojnë shumë shpejt se një grup lojtarësh nuk mund të kthehen menjëherë në një grup punëtorësh. Çdo anëtar duhet të fitojë shprehje të reja dhe njëkohësisht brenda grupit kërkohet homogjenitet. Kjo periudhë është e çmuar sepse ndërgjegjëson çdo fëmijë për vlerat e veta, të anëtarëve të tjerë të grupit dhe të atyre me të cilat bashkëpunohet. Ajo nxjerr në pah edhe liderët që kishin uzurpuar këtë rol dhe u rrit besimin të mbeturve jasht vëmendjes. Gjithashtu i lejon gjithsecilit të zërë vendin që i takon grupit.” (Shahini, 2013).*

Në të njejtën kohë Cousinet me J. Piaget dhe të tjerë, kishte treguar rëndësinë e grupit në formimin e personalitetit dhe konsideron se kjo metodë, zbatohet kryesisht në katër sektorë shkollorë ku i përgjigjet kryesisht sektorëve ku të mësuarit sistematik është i nevojshëm:

- Puna shkencore për zhvillimin e botës, të objektivave dhe vetive të tyre
- Puna gjeografike ose zbulimi i mjedisit të afërt në fillim dhe më vonë të atij të largët
- Puna historike ose kërkimi, analiza dhe interpretimi i dokumentacionit
- Puna krijuese dhe të gjitha format e të shprehurit artistik përmes vizatimeve, muzikës dhe lojës dramatike (Shahini, 2013).

Sipas teorisë konstruktiviste, nxënësit duhet të reflektojnë mbi atë që po mësojnë në mënyrë që të integrojnë njohuri të reja brenda njohurive ekzistuese (Scholnik & Abarbanel, 2006).

Teoria e Skinnerit orienton drejt të mësuarit hap pas hapi dhe me hapa të vegjël rëndësinë e aplikimit të teknikave të të mësuarit në grup, si një tjetër rrugë e suksesshme dhe e rëndësishme studimi që përdoren në fushën e arsimit e cila argumentohet me faktin se si njerëzit duhet të mësojnë njëri nga tjetri në situatat e grupeve të vogla.

Sipas tij, të mësuarit në grup aktualisht përbën një nga standardet që përdoren në institucione, në projekte të shumta dhe ka dhënë produktivitet, si dhe është një masë në vlerësimin e njerëzve për faktin se puna në grup është tashmë edhe një praktikë në shkollat tona ku jepen ushtrime apo edhe detyra të ndryshme për të parë shkallën e përvetësimit të njohurive, si dhe për të parë nga afër bashkëpunimin e raportet që krijohen brenda pjesëtarëve të grupit. Të mësuarit në grupe të vogla është e bazuar në teorinë e konfliktit sociokognitiv të Piazhesë 1932 (Garo, 2011) e cila paraqitet kur fëmijët janë të detyruar të rishqyrtojnë të kuptuarit e tyre nga kundërtheniet që ndodhin gjatë ndërveprimit me të tjerët.

Sipas tij, kur kjo ndodh fëmijët reflektojnë mbi të kuptuarit e tyre, kërkojnë informacion shtesë dhe bëjnë përpjekje për të qartësuar ose zgjidhur ndonjë kundërthenie. Mbështetur në teoritë edukative të Piazhesë 1932/1965 dhe Vigotskit 1978, fëmijët e vegjël përfitojnë shoqërisht dhe moralisht nga ndërveprimet e tyre me shokët (Baines & Kutnick, 2008).

### **2.1.2. Mësimdhënia bashkëkohore si proces përmes të cilit fitohet dituria, vlerat, qëndrimet dhe shkathtësit e nxënësit**

Nga studimi i literaturës, të mësuarit në bashkëpunim perceptohet si strategji e mësimdhënies që krijon mjedisin, mbështet nxënësit dhe shoqërohet me disa teknika, të cilat përdoren me sukses në shkollat tona.

Tek autori Nuredini (2012), gjejmë se strategjitë dhe metodat e mësimdhënies gjatë punës në grupe fokusohen me procesin e të mësuarit, ku mësimdhënësi duhet të planifikojë dhe të krijojë kushte që mundësojnë procesin e të mësuarit aktiv, vetëpunues, vetëzbulues të nxënësve, duke zbatuar strategji dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies me ndihmën e mësimdhënies direkte dhe indirekte (Nuredini, 2012).

Kjo sipas tij, ndodh kur mësuesi krijon atë ambient ku nxënësit marrin pjesë qysh prej planifikimit të lëndës-kursit, formulimin e qëllimeve të mësuarit e tyre, në zgjedhjen dhe zbatimin e strategjive dhe metodave të mësuarit si dhe në zbatimin e njohurive, përkatësisht në vlerësimin e arritjeve të suksesit, së bashku me mësimdhënësin.

Sipas hulumtimeve, me mësimdhënien e sotme ose bashkëkohore kuptojmë atë lloj mësimdhënie, e cila lehtëson me forma, metoda, teknika dhe strategji të përshtatshme procesin e të nxënësve të nxënësve.

Dituritë e nxënësit nuk mund t'i marrin vetëm në distancë, ato nuk mund të mbeten vetëm dituri, por duhet të kthehen në shprehje dhe qëndrime pra nxënësit duhet të kalojnë në një plan veprimi konkret në mënyrë individuale ose në grup (Zabeli, 2006).

Kur flasim për një mësimdhënie ndryshe, bazuar në literaturën e autorit (Fulla, 2001) duhet të kuptojmë mësimdhënien si një akt bashkëveprimi, dinamik, fleksibil, të hapur midis mësimdhënësit dhe nxënësve, ku të gjithë kanë të drejtë të marrin vendime dhe role të përshtatshme, nuk ka sukses në shkollë vetëm me libra të mira në shkolla apo direktiva.

Sipas tij, sukcesi në shkollë kërkon një proces mësimor aktiv të rinovuar me metoda, strategji, teknika të sotme mësimore të atij tipi, që ndryshe mund t'i emërtojmë edhe teknika aktive ndërvepruese gjithëpërfshirëse, të cilat bashkëveprojnë dhe luajnë njëherazi rolin për mësimdhënie e për të nxënësve të nxënësve. Arsimi në vendin tonë është përfshirë në një rikonceptim dhe në një ristrukturim të përgjithshëm, në të gjitha prerjet e tij nën frymën e “Procesit të Bolonjes” (Peshkepia, 2012).

Në këtë kuptim ‘kurrikula sot duhet të përcjellë tek nxënësit atë informacion dhe ato aktivitete, të cilat në kontekstin e sotëm kanë koherencë me zhvillimet sociale të shoqërisë së shkollës, së cilës i drejtohen’ (Zabeli, 2006). Sipas studiueve Solomon, Watson dhe Battistich 2001 (Woolfolk, 2011) gjatë tre dhjetëvjeçarëve të fundit kërkuesit kanë shqyrtuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në shkolla ku tregojnë se grupet vërtetë bashkëvepruese ushtrojnë efekte pozitive në empatinë e nxënësve, në tolerancën ndaj ndryshimeve, në ndjenjën e të pranuarit, në miqësitë, në vetëbesimin e madje edhe në frekuentimin e shkollës. Sipas tyre, përvojat e të nxënësve bashkëveprues janë thelbësore për parandalimin e shumë problemeve shoqërore që pllakosin fëmijët dhe adoleshentët.

## **2.2. Metodatat e mësimdhënies si kushte për ngritjen e cilësisë së mësimnxënies**

Metodat më të përshtatshme të mësimdhënies dhe harmonizimin e tyre gjatë shfletimit të literaturës e kuptojmë nga këndvështrime të ndryshme të studiuesve.

Studiuesi Ewald Terhart, si metoda më aktuale mësimore i analizon dhe i klasifikon: metoda e ligjërimit, mësimi problemor, mësimi në grupe, metodat e edukimit moral, metodat e orientuara në veprim, mësimdhënia, ndaj formave alternative të mësuarit dhe mësimdhënies (Terhart, 2002).

Ndërsa, sipas një qasje tjetër të studiuesit Chris, (Danellis, 2010) kuptojmë një tjetër ndarje, i cili duke folur për mësimdhënien dhe udhëheqjen e klasës ofron këto metoda: mësimdhënia direkte, mësimdhënia përmes bisedës, të mësuarit përmes punës në grupe.

Ndërkaq, në studimin e tij Hilbert Meyer percepton se ekzistojnë pesë forma të punës mësimore: mësimi në formën e kurseve, puna e fuqizuar në individualizëm dhe të lirë, puna në projekt me qëllim të mësuarit kooperues, mësimi i përbashkët si dhe të mësuarit në sheshe (Meyer, 2002).

Gjithashtu nga një këndvështrim tjetër kuptojmë se nxënësit përmes metodave të përshtatshme mund të mësojnë më mirë jo vetëm përmbajtjen, por edhe mënyrën më të dobishme për të mësuar sot (Carrberry, 2008). Në këtë drejtim, për të ndihmuar përgatitjen e nxënësve për të punuar me të tjerët, shumë metoda të mësuarit në grup përfshijnë aktivitete për të vendosur rregulla për sjellje bashkëpunuese në klasë (Brody & Nil, 2008).

Nga një këndvështrim tjetër kuptojmë tri mënyra themelore ku nxënësit mund të ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Ata mund të garojnë për të parë se kush është ‘më i mirë’, mund të punojnë individualisht drejt një qëllimi të caktuar pa i kushtuar vëmendje nxënësve të tjerë, ose mund të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Nga këto, mënyra e garimit është treguar më dominuese te nxënësit gjatë bashkëpunimit. Studiuesi Simo, (Peshkepia, 2012) konsideron se përshtatja e teknikave mësimore, shpesh mund të jetë e vlerësuar nga zbatimi i analizës kritike të qëllimeve ose programin për të cilin flitet.

### **2.2.1. Modelimi i mësimdhënies**

Gjatë shqyrtimit të literaturës, për përzgjedhjen e modeleve mësimore kemi hasur në këndvështime të ndryshme të studiuesve por kryesisht fokusi bie në të ashtuquajturën të nxënit në grup.

Për modelimin e mësimdhënies në grup bazuar në literaturën pedagogjike të autorit Zabeli, kërkohet: “për të zhvilluar aftësi të larta organizuese, për të qartësuar vlerat perspektivat, për të asimiluar informacionin nëpërmjet formave të ndryshme të të mësuarit, për të inkurajuar shprehjen e ndjenjave/ideve personale, për të përforcuar vlerësimin ndaj grupit dhe ndaj vetes, për të zhvilluar mirëkuptimin, për të krijuar një klasë, ku të jetohet bashkarisht, për të stimuluar dhe motivuar të mësuarit, për të zhvilluar aftësi vepruese, aftësi aq të kërkuara për një shoqëri që po ndryshon nga themelet dhe ku ndryshimi për këto arritje duhet të nisë nga arsimi, i cili duhet të jetë prioriteti i parë për një shoqëri që zhvillohet dhe ndryshon” (Zabeli, 2006).

Gjithashtu, në literaturën e autorit Zabeli gjejmë se sot flitet shumë në praktikën tonë shkollore për një model “mësimdhënie” dhe “të nxënit në bashkëveprim”.

Sipas tij, ‘përzgjedhja e modeleve mësimore nuk mund të bëhet e prerë me thikë, pasi shpesh ato bashkëveprojnë me njëri-tjetrin duke u përdorur për qëllime të caktuara edukative’ (Zabeli, 2006:4).

Duke vijuar më tej me aplikimin “Modele të mësimdhënies” sipas të njejtit autor, praktikat konkrete të arsimit shqiptar konsiderohet se gjithnjë e më shpesh po zënë vend terma të tilla si: mësimdhënia ndërvepruese, të nxënit në grup, loja në role, të mësuarit e individualizuar, partnerë në edukim.

### 2.2.2. Format e punës mësimore

Sipas autorit Nuredini (2012), varësisht nga kushtet objektive të shkollës dhe të metodave në procesin e punës mësimore me nxënës mund të aplikohen katër forma: puna mësimore frontale, puna mësimore në grupe, puna mësimore në çifte dhe puna mësimore individuale (Nuredini, 2012). Puna mësimore frontale, posaçërisht vie në shprehje kur mësimdhënësi është në raport direkt me nxënësit dhe përmbajtjet e nxënësve janë në raport indirekt me përmbajtjen, më konkretisht konsiderohet se puna frontale është, kur mësimdhënësi direkt punon në të njëjtën kohë me nxënësit e tërë paraleles.

Për formën e punës mësimore në çifte, në literaturë gërshetohet si një gradualitet e jo kalimin e menjëhershëm prej punës frontale p.sh. në zgjidhjen e burimeve dhe mjeteve në përpunimin e ndonjë teme, në hartimin e modeleve, gjuhë amtare etj., ku kusht i rëndësishëm tregohet aftësia e mësimdhënësit për ta organizuar dhe realizuar punën në çifte (Bebaj, 2019). Forma e punës individuale sipas të njëjtit autor, na tregon edhe vet emri për punën e pavarur të çdo nxënësi të paraleles që punon për vetë vetën, pa bashkëpunuar me të tjerët, zgjidh detyrat punuese dhe problemet. Njohja e modeleve të të mësuarit dhe dallimet mbi përparësit e tyre, ndihmon mësimdhënësit të zgjedhin metodën, e cila i përgjigjet më shumë nivelit të nxënies së nxënësve duke shërbyer si agjent për organizimin e orës mësimore me qëllim të arritjeve më të larta të nxënësve.

*Forma e punës mësimore në grupe* - Pikërisht duke i parë mangësitë e punës mësimore frontale krijohet nevoja për përdorimin e formave tjera mësimore, me përparësi më të madhe në organizimin e procesit mësimorë dhe arritjes së rezultateve mësimore. Janë mundësitë më të përshtatshme për bashkëpunimin dhe ndërveprimin e nxënësve, për zhvillimin e të menduarit, shoqërimin e nxënësve si dhe përpunimin, përvetësimin e njohurive dhe të dhënave shkencore. Gjatë veprimtarisë mësimore të nxënësve në grupe nxitet të nxënësit, interesimi, zhvillohen aftësitë, shkathtësitë, shprehitë dhe nxënësit japin mendime, shpjegime, diskutojnë dhe raportojnë për punën e tyre.

Sot në sistemet e ndryshme arsimore puna në grupe është forma më e përshtatshme dhe e suksesshme e organizimit të procesit mësimor për aftësimin e nxënësve zhvillimin e cilësive, aftësimin për të punuar në mënyrë të pavarur dhe përmes ndërveprimit. Zhvillimi i mësimdhënies në formën grupore ngritë cilësinë e organizimit të procesit mësimor që njëherit kërkon përgatitje dhe përpjekje të nxënësve gjatë të të nxënësit.



### 2.3. Organizimi i orës mësimore në grupe

Puna në grupe është një aktivitet i fuqishëm mësimor ku elementi thelbësor është puna në bashkëpunim, e cila në ndryshim nga puna individuale, procesi i bashkëpunimit influencon rezultatet e të mësuarit (Shahini, 2013). Në një rishikim të kërkimeve 90 vjeçare në këtë fushë, studiuesit Xhanson dhe të tjerët 1998 (Shahini, 2013) zbuluan që procesi i bashkëpunimit i përmirëson rezultatet e nxënies më shumë, sesa puna individuale, sa më shumë kohë kalohet në punën në grup, aq më shumë theksohen qasjet pozitive të nxënësve.

Sipas tyre, procesi i bashkëpunimit funksionon në lidhje me promovimin e arritjeve në nxënie, sidomos në theksimin e arritjeve akademike, sjelljeve të nxënësve si dhe mbajtjes mend të lëndës nga ana e nxënësve.

Gjatë shqyrtimit të literaturës për sukses në punës mësimore në grupe konsiderohet mënyra e organizimit të orës mësimore e udhëhequr nga mësimdhënësi. Autori (Garo, 2011) thekson se “orët e mësimit s’mund të dalin të sukseshme, nëse mësuesi nuk mendon për të dhe nuk planifikon me kohë”.

Për ta kuptuar më mirë procesin e organizimit të punës mësimore në grupe, nga autori (Nuredini, 2012) ndjekim disa udhëzime: përgatitjen-hyrjen ku mësimdhënësi-pedagogu e njofton tërë paralelen me temën, përkatësisht me detyrat punuese që duhet ti punojnë nxënësit në grupe pavarësisht duke i udhëzuar në mënyrën e punës, përdorimin e materialit, burimeve, mënyrën e shënimit të rezultateve si dhe për qëllimet e mësimit. Sipas tij, pas vendosjes së nxënësve në grupe mësimdhënësi u jep detyrat e punës, sipas numrit të grupeve të nxënësve që i ka përgatitur në formë të fletëve mësimore ose në formë tjetër varësisht nga natyra e detyrave.

Gjthashtu, autori thekson se detyrat ose fletëzat mësimore duhet të përfshijnë këto elemente: detyrën çka duhet punuar-zgjidhur, mjetet, materialin që duhet shfrytëzuar si dhe mënyrën e burimit varësisht se në cilën etapë të procesit mësimorë do të shfrytëzohet fletëza mësimore, si në shpjegim ose ushtrime etj.

Për ndarjen e brendshme të grupit dhe organizimin e punës, në literaturë sugjerohet se të gjitha grupet mund t’i marrin detyrat e njëjta si p.sh.për gara, për sukses, si dhe detyrat e diferencuara ku çdo grup punon një pjesë të detyrës ose temës dhe në mbarim ndërlidhet rezultati për detyrën ose temën e punuar. Sipas po të njëjtit autorë, në aspektin pedagogjik me rëndësi është se këtu nxënësit duhet të aplikojnë procedimet e të mësuarit, leximin, shkrimin, bisedat, vizatimet, matjet, veprimet praktike etj, në formë të vet punës, vet fitimit të njohurive ku mësimdhënësit e përcjell punën e grupeve, iu jep udhëzime plotësuese, sipas nevojës, vërejtje, i nxitë, etj.

Sipas autorit, në këtë mënyrë nxënësit ushtrohen edhe për referimin e punëve si dhe për sistematizimin e detyrave në të njëjtën detyrë ose temë. Pas hyrjes së grupeve të caktuara të nxënësve të paraleles dhe dhënies së detyrave, autori percepton se tashmë grupet e nxënësve fillojnë të punojnë pavarësisht ku duhet të jenë aktivë, si dhe të zgjedhin ose ia zgjedh mësimdhënësi udhëheqësin. Meqenëse, puna në grupe kërkon edhe konsultimet në mes të anëtarëve, kjo s' do të thotë se duhet lejuar edhe zhurmën jo normale (Nuredini, 2012).

Sipas studiuesve Brown 1994 dhe Freeman 1998 (Baines, 2008) gjejmë se vlerësimet gjatë punës mësimore në grupe mund të bëhen nga:

- a) mësimdhënësit e lëndës,
- b) me vetëvlerësim të nxënësve dhe vlerësimi nga kolegët ose nga një ekip i jashtëm.

### **2.3.1. Madhësia dhe përbërja e grupit**

Një faktorë tjetër i rëndësishëm në organizimin e orës mësimore në grupe, është madhësia dhe përbërja e grupit. Nga shumë hulumtime, është e njohur se nxënësit me aftësi të lartë janë të suksesshëm pa marrë parasysh përbërjen e grupit dhe përmbajtja e bisedës është e orientuar në të mësuarit, të cilët janë edhe bartës të ndihmës në grupe, por problematika theksohet tek nxënësit me aftësi të ulëta. Me formimin e grupeve nxënësit vendosen në bankat e caktuara ku duhet të sigurohet bashkëpunimi në mes të anëtarëve të grupit (Nuredini, 2012).

Sipas autorit (Musai, 2003) grupet duhet të formohen në bazë të nivelit të aftësive mësimore, ineresave, karakteristikave të personalitetit, shprehive shoqërore apo një kombinim të këtyre faktorëve. Nga po i njëjti autor, gjëmë se përvoja tradicionale e vendeve të zhvilluara tregon se grupet e të nxënësve në bashkëpunim kanë qenë të ndërtuar në mënyrë të tillë që të kishin në përmbajtje një nxënës mbi nivelin mesatar, dy në nivelin mesatar dhe një nën nivelin mesatar dhe vështirësia e kësaj qëndron në faktin se kjo në mënyrë të zhurmshme kategorizon nxënësit, në një kohë që të gjithë nxënësit kanë fusha me aftësi më të mëdha apo më të vogla.

Sipas një studimi, rezultatet tregojnë se duke aplikuar të mësuarit bashkëpunues mes grupeve homogjene dhe heterogjene, grupet homogjene kanë treguar arritje më të larta se sa grupet heterogjene (Baines, 2008).

Ndërkaq, gjatë studimit të literaturës lidhur me punën grupore vend me rëndësi zë edhe udhëheqësi (lideri), përkatësisht udhëheqja (regjimi) e grupit.

Koha e qëndrimit të nxënësve në një grup varet nga karakteristikat e nxënësve në klasë dhe nga natyra e detyrave për të cilat ato janë duke punuar prandaj me rëndësi thelbësore konsiderohet që nxënësit të grupohen me kujdes në fillim të vitit apo kurdoherë që formohen, në mënyrë që përvoja e nxënësve të jetë pozitive dhe e përforcuar (Musai, 2003)

Për madhësinë dhe formimin e grupeve gjejmë disa studime të tjera. Kështu nga studiues të ndryshëm gjejmë se “grupet shpesh qëndrojnë bashkë nga dy, deri në gjashtë javë dhe gjatë kësaj kohe, anëtarësimi i grupit ndryshon, me qëllim që të lejojë nxënësit të bashkëpunojnë dhe të përkujdesen për njëri tjetrin”.

(Garner & Kaqulich, 2009) sugjerojnë grupet punuese prej katër anëtarësh, si grup i mjaftueshëm për parandalimin e fshehjes së ndonjërit nga anëtarët e grupit, i mjaftueshëm për të mbajtur grupin, funksionale nëse ndonjë anëtar i grupit është i padisponueshëm si dhe lehtë ndahet në çifte për të punuar me materialin mësimor.

Nga një studim tjetër, kriteret e formimit të grupit mund të jenë “sipas interesimeve, aftësive, raporteve sociale, afërsisë së banimit etj”, (Kryeziu, 2012). Në përgjithësi, ky studim sugjeron se grupet me katër ose pesë anëtarë punojnë më mirë se sa grupet më të mëdha, të cilët zvogëlojnë mundësinë e çdo anëtari për të marrë pjesë në mënyrë aktive.

Roli i mësuesit - Një faktorë tjetër i rëndësishëm për organizimin e sukseshëm të orës mësimore është padyshim roli i mësimitdhënësit. Në këtë drejtim, perceptohet se mësimitdhënësi përpara se të fillojë me punën në grupe duhet të përgatitë materialin dhe veglat e punës, gjegjësisht materialin didaktik ndërsa “roli i mësimitdhënësit në këtë formë të punës është i dorës së dytë dhe ka karakter këshillues” (Kryeziu, 2012).

Gjithashtu, një kujdes i veçantë i sugjerohet mësimitdhënësit në menaxhimin e procesit të të mësuarit në grupe në klasë, ku mësimitdhënësi duhet të mendojë se si mund t’i ndihmojë nxënësit të reflektojnë mbi atë që kanë mësuar me anë të reflektimit me shkrim, diskutimit dhe pyetjeve e ndërsjella në mes nxënësve (Silver & Perini, 2007).

Pa një planifikim dhe mbikqyrje të suksesshme nga ana e mësimitdhënësit, ndërveprimet e grupit mund të pengojnë të nxënët dhe në vend që t’i forcojnë marrëdhëniet shoqërore në klasë, i dobësojnë ato (Woolfolk, 2011).

Një rrezik të kësaj natyre, autori (Woolfolk, 2011) e argumenton duke theksuar se “shumë veprimtari mund të kryhen në grupe, por mësimitdhënësit duhet të sigurohet që çdo nxënës i grupit të angazhohet në detyrë, sepse nganjëherë ndodh që një ose dy nxënës e përfundojnë detyrën duke bërë punën e gjithë grupit”.

Ndërkaq, studiuesi (Danellis, 2010) sugjeron se “mësimdhënësit nuk kanë për detyrë t’i imponojnë ide të caktuara nxënësve, por detyra e tyre është që, si anëtarë të komunitetit të për zgjedhin ato ide e influenca që do të ndikojnë te nxënësit e në të njëjtën kohë t’i ndihmojnë ata që t’u përgjigjen në mënyrën e duhur këtyre ideve”.

Janë të shumtë studiuesit të cilët kanë trajtuar rolin dhe detyrat e mësimdhënësit. Bazuar tek autori (Simo, 2007), gjejmë udhëzime të rëndësishme: e para, mësimdhënësi duhet të shfaqë mirë aftësi komunikuese në planifikimin dhe strukturimin e eksperiencës mësimore dhe roli i tij mund të jetë më pak autoritar ose autokratik se në situatat ekspozuese bazë.

Ndërveprimi mësues – nxënës - Një faktorë tjetër i rëndësishëm në të mësuarit bashkëpunues, konsiderohet ndërveprimi mësimdhënësit-nxënës. Tek autori (Musai, 2003) gjejmë se marrëdhëniet midis strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit të nxënësve janë të ndërlikuara dhe “veprimet e mësuesit nuk mund të përvetësohen në mënyrë magjike në të nxënit e nxënësve, vetëm nxënësi mund të mësojë”. Sipas autorit, në një nivel të caktuar bazë, nxënësit, së pari duhet të tregojnë vëmendje tek informacioni, ndërsa mësimdhënësit shpenzojnë shumë kohë për të nxënit, duke përmirësuar menaxhimin e klasës e duke i mbajtur ata të motivuar dhe të përfshirë.

Aftësitë shoqërore dhe detyrat lidhur me komunikimin - Një shpjegim mbi aftësitë shoqërore dhe detyrat lidhur me komunikimin e gjejmë tek studiuesit Cohen 1940 dhe Kagan 1994 (Woolfolk, 2011) sipas të cilëve kur qëllimi i të nxënit në grupe bashkëmoshatarësh është rritja e aftësive shoqërore ose rritja e shkallës së mirëkuptimit ndërgrupor dhe vlerësimi i diversitetit, caktimi i roleve dhe funksioneve brenda grupit mbështetë komunikimin. Në këto situata, studiuesit theksojnë se do të ishte e dobishme që rolet udhëheqëse të ndëroreshin, në mënyrë që edhe grupet e nxënësve me numër më të vogël të kenë mundësi të demonstrojnë dhe të zhvillojnë, ku anëtarët e grupit të mund të provojnë aftësitë drejtuese të çdo individi.

Ndërsa, për të punuar me grupe në mënyrë efektive në klasë, sugjerohet se duhet kushtuar vëmendje: aranzhimin e uljes së nxënësve në klasë, madhësisë së grupeve, numrit të grupeve, stabilitetit të grupeve dhe përbërjes së grupeve (Baines, 2008). Nga një rezultat tjetër të njejtë studiues përceptohet se “marrëdhëniet brenda grupit janë të mira kur nxënësit inkurajohen të respektojnë mendimin e anëtarëve të tjerë, kontribuojnë në suksesin e grupit dhe i ndajnë vështirësit kur hasin në to”.

### 2.3.2. Role të mundshme të nxënësve në grupet e të nxënësve

Përveç rolit të mësimit, komponentë tjetër për të mësuarit në bashkëpunim konsiderohet edhe roli i nxënësve për rëndësinë e së cilës studiuuesit theksojnë: “nxënësve, mësojnë dhe ngrihen nga përvojat me njëri-tjetrin, ndërveprimi i vazhdueshëm në mes tyre ofron mundësi për të mësuar në të gjitha nivelet dhe kjo ndihmon në përgjithësi që secili të jetë mësimit dhe nxënës në fazë të ndryshme të jetës” (Garner & Kaqulich, 2009).

Të mësuarit bashkëpunues mund të zhvillohet në çdo kohë kur nxënësve punojnë së bashku - për shembull, kur ata ndihmojnë njëri-tjetrin me detyrat e shtëpisë (Education, 2004).

Hulumtimet nga autori (Woolfolk, 2011) sugjerojnë se në varësi nga qëllimi i grupit dhe moshën e pjesëmarrësve, caktimi i këtyre roleve mund t’i ndihmojë nxënësve të bashkëpunojnë dhe të mësojnë. Sipas tij, nxënësve mund të kenë nevojë t’u mësohet si ta luajnë rolin me produktivitet dhe rolet duhen ndërruar në mënyrë që nxënësve mund të marrin pjesë në aspekte të ndryshme të të nxënësve në grup.

Role të identifikuar nga ky autorë dolën:

- ✓ Nxitës - Nxit nxënësve e pazellshëm ose të ndrojtur të marrin pjesë
- ✓ Lavdërues/gjallërues - Shpreh vlerësim për kontributet e të tjerëve dhe njih arritjet
- ✓ Ekuilibruer - Barazon pjesëmarrjen dhe bën që asnjë të mos dalë mbi të tjerët
- ✓ Trajner - Ndhmon në përmbajtjen mësimore, shpjegon konceptet
- ✓ Menaxher i pyetjeve - Siguron të gjithë nxënësve të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje
- ✓ Kontrollues - Kontrollon nivelet e të kuptuarit në grup
- ✓ Përgjegjës i detyrës - Kujdeset që anëtarët e grupit të përqëndrohen në detyrë
- ✓ Regjistruer - Mban shënim, idetë, mendimet dhe planet
- ✓ Reflektues - Mban grupet në dijeni në lidhje me përparimin (ose mungesën e përparimit)
- ✓ Kujdestari i rregullt - Mbikëqyr mbajtjen e qetësisë
- ✓ Kujdestari i materialeve - Mbledh dhe kthen materialet

Caktimi i roleve - Nga shumë hulumtime që kemi hasur, arsyeja pse mësimit u caktojnë role nxënësve konsiderohet nxitja për bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e plotë (Woolfolk, 2011). Sipas studiuësve, në grupet që fokusohen në aftësitë shoqërore, rolet duhet të mbështetin dëgjimin, inkurajimin dhe respektin për ndryshimet, ndërsa mësimit duhet të sigurohen që rolet të mbështetin të nxënësve.

Gjithashtu, në literaturë gjejmë se në grupet që përqëndrohen te praktika, te përsëritja ose te zotërimi i aftësive bazë, rolet duhet të mbështetin këmbënguljen, inkurajimin dhe pjesëmarrjen, ndërsa në grupet që përqëndrohen te një nivel më i lartë zgjidhjesh të problemeve ose të një procesi të nxëni më kompleks, rolet duhet të nxitin diskutime të thella në mendim, shpalosje shpjegimesh e konstatimesh dhe krijueshmëri (Woolfolk, 2011).

Gjatë shfletimit të literaturës, gjejmë se jo të gjitha rolet janë të nevojshme për çdo aktivitet apo detyrë që zhvillohet në grupe, mësimdhënësit mund të zgjedhin rolet e veçanta për të përcaktuar paraprakisht nxënësve, ose ata mund të caktojnë rolet në mënyrë të rastësishme.

Shumë faktorë duhet të merren parasysh kur mësimdhënësi zgjedh strategjinë e të mësuarit bashkëpunues, duke përfshirë natyrën e aktivitetit ose detyrës, natyrën e strukturës gjuhësore që përdoret si dhe nivelin e bashkëpunimit të nxënësve (Education, 2004).

Përveç roleve, sipas studiuësve konsiderohet se përcaktimi i përgjegjësive të qarta që nga fillimi është një nga detyrat kryesore për të ndërtuar një grup efektiv

Tek autori (Woolfolk, 2011) gjejmë një studim ku rolet mbështeten në strategjitë shkencore të parashikimit dhe teorizimit, të përmbledhjes së rezultateve dhe të parashikimeve dhe të teorive me rezultatet. Studimi tregon se shpesh strategjitë e të nxënit bashkëveprues përfshijnë dhënien e raporteve nga grupet përpara gjithë klasës. Në këtë studim, disa prej anëtarëve të auditorit i'u caktuan role për të kontrolluar raportet për lidhje të qarta midis parashikimeve dhe teorive. Nxënës të tjerë të auditorit verifikonin qartësinë në konstatime kurse, pjesa tjetër e nxënësve ishin përgjegjës për të vlerësuar se në ç'shikallë cilësie raportet e grupeve arrinin të lidhin parashikimin, teorinë dhe konstatimet. Nga këto kërkime tregohet se përdorimi i këtyre roleve nxit dialogun në klasë, të menduarit dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe përvetësimin e koncepteve.

Në anën tjetër, përceptohet se përgjegjësitë duhet të janë të lidhura ngusht me detyrat specifike ose aktivitet që anëtarët e ekipit pritët t'i përfundojnë në varshmëri me rolet që kanë (KEC, 2011).

Udhëheqësi, përceptohet të jetë i gatshëm për çfarëdo që ndodh brenda grupit, t'u përgjigjet në mënyrë të përshtatshme, kur ato evoluojnë si dhe komunikimi i mirë në mes të udhëheqësve konsiderohet një nga sfidat e punës në grup kur nxënësit përballen me një gamë të sjelljeve të ndryshme apo përgjigjeve nga të pranishmit (KEC, 2011).

### 2.3.3. Nxitja e punës në grupe dhe efekti i saj te nxënësit

Studimet e shumta perceptojnë se aftësitë e të menduarit, komunikimi i qartë dhe të dëgjuarit aktiv gjatë bashkëpunimit me shokët tregojnë perspektiva të ndryshme në mënyrë produktive për të punuar në grupe. Fryma e bashkëpunimit mund të arrihet kur një grup bashkarisht përballet për ta bërë një punë të vështirë (Fisher & Everlone, 2009).

Sipas studiuesve Johnson&Johnson 1992, (Musai, 2003) tiparet dalluese që karakterizojnë të mësuarit bashkëpunues janë:

*Ndërvarësia pozitive*, si tipar i rëndësishëm në strukturimin e të mësuarit bashkëpunues e cila i mëson nxënësit se jeta në shkollë për gjithsecilin prej tyre përmiresohet shumë, kur ata korrin sukses.

*Komunikimi i drejtëpërdrejtë*, konsiderohet i rëndësishëm gjatë të mësuarit bashkëpunues sepse njësitë në grupe të vogla i lejojnë nxënësit të punojnë drejtëpërdrejt me njëri-tjetrin, të këmbëjnë ide dhe mendime, të arrijnë mirëkuptim të përbashkët dhe të punojnë si një skuadër për të siguruar suksesin dhe pranimin e çdo anëtari.

Gjithashtu, *përgjegjësia individuale*, perceptohet se në të nxënët në bashkëpunim secili nxënës mban përgjegjësi për progresin mësimor të tij/saj dhe kryerjen e detyrave dhe individët mund të mbajnë përgjegjësi edhe nëpërmjet notave të bazuara në arritjet në lëndët mësimore dhe shprehjet sociale, si dhe përmes vlerësimeve të kryera nga mësuesit, shokët apo shoqet e klasës.

*Zhvillimi i shprehjeve sociale*, konsiderohet se gjatë të nxënët në bashkëpunim u ofron nxënësve një mundësi për të zhvilluar shprehjet ndërvetjake të nevojshme për të arritur sukses.

Ndërsa, *vlerësimi i grupit* sipas studiuesve konsiderohet i rëndësishëm sepse nxënësit kanë nevojë të vlerësojnë dhe diskutojnë se deri në ç’masë ata kanë arritur qëllimet e tyre si dhe çfarë veprimesh do të ndihmojnë grupin e tyre për të arritur më shumë sukses.

Ndërkaq, Livingston edhe Lynch 2002 (Shahini, 2013) konsiderojnë se ‘nxënësit shpesh ndjehen të braktisur nga puna e përbashkët dhe se nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme duke u përpjekur të punojnë individualisht’.

Prandaj hulumtimet sugjerojnë se kur arsimtari zbaton grupet formale duhet të ofrojë komponentat themelore të të mësuarit kooperues si: varshmëria pozitive, përpunimi grupor, nxitja direkte e interaksionit, përgjegjësia individuale dhe grupore (Kryeziu, 2012). Në literaturë, perceptohet se mësuesit e pedagogët që kanë zhvilluar me sukses qasjet bashkëpunuese, kanë arritur në përmirësimin e marrëdhënieve midis nxënësve dhe mes nxënësve e mësuesit.

Në klasat me grupe të nxënësve me aftësi të përziera është më e lehtë për të menaxhuar, sepse mësimi bëhet më fleksibil, nxënësit mund të mësojnë dhe të ndihmohen nga njëri-tjetri, zhvillojnë aftësitë bashkëpunuese e kanë potencial të ndryshojnë natyrën e marrëdhënieve në klasë, duke i bërë ata më produktivë (Shahini, 2013). Gjithashtu, në qasjen bashkëpunuese raportohen edhe përvojat efektive përmes teknologjisë informative që krijon mundësi për integrimin e burimeve dhe menaxhimin e të mësuarit.

#### **2.3.4. Karakteristikat e punës në grupe**

Forma e punës mësimore në grupe mund të ndahet qartazi në dy pjesë: "akti i kërkesës, i gjetjes ose i krijimit, i cili bëhet në grupe më të vogla të nxënësve si punë e parë vërtetë në grup, si dhe akti i referimit, vërtetimit dhe diskutimit" (Musai, 2003).

Efektiviteti i grupit mund të arrihet duke ndarë pritjet me njëri-tjetrin, duke i lejuar të marrë pjesë në procesin e planifikimit, duke vlerësuar tiparet e personalitetit të njëri-tjetrit dhe duke reflektuar një qëndrim pozitiv ndaj punës në grup (Gixhari, 2016). Një pikëpamje alternative është se, kur fëmijët punojnë së bashku, ata mund të arrijnë në zgjidhje të problemeve dhe të kuptuarit e koncepteve që nuk do të kishte qenë e mundur, në qoftë se ata kishin punuar vetëm (Baines, 2008).

Disa studime për punë të suksesshme në grupe, preferojnë që nxënësit të bëjnë atë që e kanë parë, të ballafaqohen me atë që ende nuk e kanë parë, të nxiten për zgjidhjen e problemit dhe të mendojnë për gjerat në mënyrë më të thellë (Garner & Kaqulich, 2009).

Në këto raste, theksohet e rëndësishme se çdo mësues duhet të dijë të bëjë dallimin midis punës individuale, si pjesë e grupit dhe punës së individit si pjesë e ekipit (Baines, 2008).

Sipas studiuesit Vitak (1960), kuptojmë se grupet e vogla mundësojnë zhvillimin dhe ushtrimin e aftësive për të analizuar, sintetizuar, krahasuar, gjykuar dhe vlerësuar njohuritë, por edhe shkëmbimin e ideve, dhënien e argumenteve etj. Gjithashtu, ky studiues percepton se punën në grupe të vogla e karakterizon dialogu, debati, diskutimi si dhe shkëmbimi i ideve, reflektimi, interaktiviteti dhe puna e pavarur, prandaj konsideron se puna në grupet e vogla është efikase edhe për faktin përveç që rrit motivimin dhe përgjegjësinë e nxënësve, ndikon edhe në zhvillimin e plotë intelektual dhe pavarësinë e brendshme sipas metodës së ndarjes në grupe. Ndërveprimet e nxënësve ndodhin me intensitet të ndryshëm në faza të ndryshme gjatë evoluimit të grupit (Glassman, 2009).



### 2.3.5. Mekanizmat e punës në grup

Mbështetur tek autori Koliqi (1996), hulumtimet identifikojnë se brenda grupit krijohen forcat (mekanizmat) dinamike, të cilat ndikojnë pozitivisht në integrimin e grupit, ndërsa nga ana tjetër, në gjirin e grupit mund të sajohen edhe disa forca disruptive (shkatërruese), të cilat veprojnë në dëm të integritetit dhe të efikasitetit të punës në grup.

Bazuar në këto hulumtime, sipas studiuesit (Koliqi, 1996) për mësimdhënie të suksesshme në klasë gjejmë disa komponente thelbësore sfiduese:

- ✚ Bisedat e fokusuara gjatë mësimit me nxënës të aftësive të përziera, janë shprehje e drejtëpërdrejtë e faktorëve të grupit dhe të raporteve midis tyre.
- ✚ *Ndjenja dhe gatishmëria për bashkëpunimin* e anëtarëve të grupit është një nga forcat e brendshme integruese të grupit. Kjo konsiderohet se bën të mundshme bashkimin e të gjitha forcave të grupit dhe mobilizimin e tyre për arritjen e objektivit të përbashkët grupor, ndërsa mungesa e ndjenjës për bashkëpunim shpie kah mospësuksesi, respektivisht kah shkatërrimi të grupit.
- ✚ *Solidariteti* forcë tjetër e grupit konsiderohet midis pjesëtarëve të grupit i cili ka të bëjë me ndihmën dhe me sakrificën personale të pjesëtarëve të grupit në të mirë të pjesëtarëve tjerë të grupit.
- ✚ *Simpatia*, si fuqi tërheqëse e individit ndaj individit apo ndaj individëve tjerë, përceptohet se ka rëndësi të madhe si forcë kohezive (integruese) e mobilizuese të anëtarëve të grupit. Por, simpatia (animi) e tepruar nuk konsiderohet se është konstruktive, sepse shpie kah diskriminimi midis anëtarëve të grupit, kah dobësimi e shkatërrimi i tij.
- ✚ *Sugjestionin*, si ndikim i fuqishëm, qoftë nga udhëheqës i grupit, apo ndokush tjetër, nëpërmjet të cilit ndikon në mobilizimin e përgjithshëm të pjesëtarëve të grupit në drejtim të arritjes së një objektivit të lartë shoqëror.

Mekanizëm tjetër konstruktiv i grupit sipas të njëjtit autor përceptohet edhe stimulimi social, në ato situata kur grupi (ambient social) ndikon pozitivisht në angazhimin e anëtarit, ose të anëtarëve të tij.

Gjithashtu, nga burime të njëjta gjejmë se përkundër këtyre mekanizmave (forcave) socio-psikologjike, brenda grupit paraqiten edhe disa forca (mekanizma) të tjera, të cilat ushtrojnë ndikimin e tyre destruktiv në drejtim të pengimit të punës në grup, përkatësisht në shkatërrimin përfundimtar të tij:

- ✚ *Antipatia*, e cila mund të paraqitet si ndjenjë përkatëse e individit ndaj individit, kjo forcë disruptive e pengon dukshëm integrimin e grupit dhe shkon në dëm të identifikimit social.
- ✚ *Egoizmi*, si tek udhëheqësi, ashtu edhe te cilido pjesëtar i grupit, mund të shprehet negativisht në dinamikën e gjithmbarshme të grupit, sepse me çdo kusht interesat personale vihen mbi interesat e përgjithshme të grupit.
- ✚ *Kompleksi i inferioritetit* është një ndër mekanizmat disruptivë të grupit dhe ka të bëjë me bindjen e ndonjërit nga anëtarët e grupit, apo të disa prej tyre për aftësitë e mangëta të tyre, në krahasim me anëtarët e tjerë të grupit.

Tek autori Nuredini, gjejmë se kombinimi i të mësuarit bashkëpunues me strukturat e tjera në klasë është i domosdoshëm, sepse p.sh. mësuesi që tepër e zbaton të mësuarit bashkëpunues e heton se s'është efektiv, edhe pse u thotë nxënësve formoni grupet, ku një nxënës i thotë: “një kohë duhet të punoj vetë, jam i lodhur nga interaksioni i rregullt, dua të punoj në qetësi, disa gjëra më mirë i mësoj vet” (Nuredini, 2012).

Mësuesit, duhet të jenë të hapur gjatë procesit mësimorë në atë mënyrë që të krijojnë të mësuarit bashkëpunues ku përfitojnë edhe nxënësit edhe mësuesit (Samsudin & Chij, 2013)

Me sa u tha më lart, për funksionimin efektiv brenda anëtarëve të grupit qëndron rëndësia e integritetit të faktorëve pozitiv të anëtarëve të grupit e përcjellur me mekanizmat psiko-social brendapërbrenda grupit, ndërsa në anën tjetër kuptojmë faktorët e mundshëm negativ si antipatia, egoizmi, diskriminimi, e kompleksi inferioritetit që ushtrohen brenda anëtarëve të cilët bëjnë që grupi të shkojë kah shkatërrimi. Në këtë rast dhe në atë të udhëheqësit të grupit, roli i të cilëve pasqyrohet në mënyrën e funksionimit brenda grupit bie mbi monitorimin dhe rolin e mësuesit, detyrë e të cilit konsiderohet shmangia e ndikimit të grupit nga këta faktorë.

### **2.3.6. Anët pozitive të të mësuarit në grupe**

Gjatë shfletimit të literaturës për rëndësinë e të mësuarit në grupe, identifikojmë aspektet pozitive të shumta: motivimi i nxënësit që e ka zgjedhur vetë dhe lirisht, së cilës ai do t'i kushtohet tërësisht, zhvillimi i shpirtit të iniciativës dhe i krijimtarisë për të organizuar punën, kërkimi i burimeve të dokumentacionit, lidhja me një grup tjetër që shpesh bëhet grup miqësh, etj., (Kraja, 2006).

Në literaturë tregohen përparësitë tjera:

- ✚ Nxënësit janë pjesëmarrës aktiv në diskutim dhe zhvillojnë shprehje të nxënimit në bashkëpunim;
- ✚ Nxënësit kanë një strukturë për të vlerësuar të dy anët e një çështjeje apo pyetjeje dhe nxiten të përpunojnë prova apo argument kundërshtuese përpara se të shprehin pikëpamjet e tyre;

Nxënësit shkruajnë duke përdorur mbështetje të organizuar mirë dhe të zhvilluar për pozicionet e veta (Musai, 2003). Gjithashtu, përkrahja sociale e bashkëmoshatarëve gjatë punës nxënësve u ndihmon ta reduktojnë stresin (Dakes, 2005).

Bazuar tek autori Simo (2000), në përshtatjen e rezultateve të dëshmuara ose objektivave të një kursi me metodat mësimdhënëse të pëlqyeshme është të arrihen ato, shpejt bëhet e qartë se asnjë metodë e vetme s'është e përshtatshme në të gjitha rrethanat, dhe që një kombinim i përshtatshëm i metodave mësimdhënësve mund të kërkohet.

Për suksesin gjatë të mësuarit në bashkëpunim, theksohet se “marrja e njohurive përmes të mësuarit bashkëpunues kërkon kohë dhe përpjekje, sukcesi i ndryshimit nuk mund të ndodh brenda natës” (Marzano, 2007). Shumë hulumtime konstatojnë se bashkëpunimi është çelësi i arritjes i këtyre ndryshimeve të pikëpamjeve, në këtë drejtim dobia e punës mësimore arrihet kur nxënësit shoqërohen, i ndihmojnë njëri-tjetrit, më mirë kuptojnë kur duhen qartësuar të tjerët, si dhe vihen në rolin e mësimdhënësit për të mësuar (Simo, 2007). Përparësitë tjera perceptohen: nxënësit janë bartës kryesorë të aktivitetit mësimor, punojnë pavarësisht në burimet mësimore, zhvillojnë aftësitë e veta dhe përsosin teknikën e të mësuarit e që kjo i motivon shumë, ka bashkëpunim në mes të nxënësve në punë në grupe, nxënësit e ndiejnë veten më të lirë, më të natyrshëm në aktivitete, punojnë sipas aftësive individuale etj., (Kryeziu, 2012).

Sipas autorit Peshkepia, të mësuarit bashkëpunues rrit thellësinë e të kuptuarit të përmbajtjes, rrit motivimin për pjesëmarrje më të madhe në mësim, procese të nivelit të lartë, këndvështrime dhe pikpamje të ndryshme, përmirëson të nxënimit e njohurive dhe të shprehive sociale, zhvillon qëndrimet pozitive, zhvillon aftësitë për të zgjidhur probleme të ndryshme, ofron një praktikë të caktuar në zbatimin e koncepteve dhe të informacionit (Peshkepia, 2012). Nga një studim tjetër i studiuesve Jones & Jones (2008) kuptojmë se nxënësit duke punuar ngushtë njëri me të tjetrin, mund të vlerësojnë anët e forta dhe dobësitë e tyre, duke shfrytëzuar diversitetin e grupit për të përmbushur qëllimet e tyre të përbashkëta.

### 2.3.7. Anët negative të mësimit në grup

Në literaturë të ndryshme gjejmë se dobësitë theksohen si pasojë e jo përgatitjes së mësimit në grup, e jo të punës në grupe. Sipas Burdett (2007) shqetësimet lidhur me implikimet gjatë punës në grup janë të pranishme. Ndër anët negative të të mësuarit në grup mund të veçohen: nxënësit shpesh gabojnë, s'mund të dallojnë atë që është primare, sekondare, terciare, shpesh s'dijnë si të veprojnë etj., (Kryeziu, 2012).

Sipas një këndvështimi të studiuesit (Simo, 2007) gjejmë dy komponentë tjerë të vështirësive gjatë punës në grupe: Vështirësitë organizative dhe problemet e pikëpamjes.

*Vështirësitë organizative* - Vëzhgimi i ushtrimeve mësimore në grup sipas autorit mund të nxjerrë një numër problemesh organizative, fakti tregohet se shpesh është e vështirë të vendosen ato brenda një kurrikulumi mësimdhënës normal veçanërisht në qoftëse, ushtrimi është i gjatë ose kërkon një numër të madh pjesëmarrësish, staf mësimdhënës ekstra, kushte specifike etj.

*Probleme të pikëpamjes* - Një mangësi potenciale e të gjithë metodave mësimore në grup, sipas të njejtit autor tregohet të jetë se ato kërkojnë bashkëpunim aktiv të pjesëmarrësve, e në disa çështje konsiderohet se ky bashkëpunim s'mund të jetë i gatshëm sepse nxënësit p.sh. nuk futen në ushtrim sepse ata ndjejnë që kjo do të jetë një humbje kohe ose kanë frikë të marrin pjesë. Në raste të tjera, autori konsideron se ata mund të jenë kundërshtues, dhe në këtë rast ata kërkojnë të bëjnë një angazhim sa më real me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të grupit, që shumë ushtrime mësimore të punës në grup e kërkojnë, sepse ato s'ndiejnë që kanë aftësi të nevojshme dhe s'duan të nxjerrin veten e tyre përballë problemeve të tyre, këto janë probleme të pikëpamjeve të kufizuara nxënës-nxënës.

Ndërsa sipas studiuesve Linden, Nago, dhe Parsons 1985 (Shahini, 2013) ankesat më të zakonshme nga nxënësit lidhur me menaxhimin e punës së nxënësve ishin rreth çështjes së shpërndarjes së ngarkesës së punës, si mjet shumë i rëndësishëm i të mësuarit në parandalimin e konfliktit në grup i cili mund të jetë si kërcënim për qëndrueshmërinë e grupit, sepse nëse polemika përshkallëzohet në konflikt, procesi i nivelit të mësimit nuk arrihet.

Nga përvoja e arritjeve pozitive të të mësuarit në grup në literaturë, konstatohet i domosdoshëm përdorimi i objektivave që përfshijnë mendimin krijues e komunikues, si pjesmarrja aktive e nxënësve dhe ekspozimi i mendimeve të tyre në aktivitete, ndërsa në aspektin e anëve negative nxirren pikëpamje nga më të ndryshmet prej atyre të mangësive organizative të reflektuara si kundërshtues, si pjesmarrje jo reale e anëtarëve të grupit dhe mënyra të ndryshme ku nxënësit nuk duan të nxjerrin veten përballë problemeve.

### 2.3.8. Teknikat e të mësuarit në grupe

Teknikat e të mësuarit i konsiderojmë një ndër faktorët e rëndësishëm për aplikimin e suksesshëm të orës mësimore në grupe. Bazuar tek autori (Zabeli, 2010) teknikat e të nxënit ndërveprues inkurajojnë bashkëpunimin, por qëllimi përfundimtar i tyre është zhvillimi i mendimit të pavarur, ku në vend të të nxënit klasik vetëm përmes librit apo dëgjimit të mësimdhënësit, tani kjo realizohet përmes:

1. Ndërveprimit midis mësimdhënësit dhe nxënësit;
2. Ndërveprimit nxënës: nxënës në çifte apo në grup;
3. Ndërveprimit nxënës: libër apo burime tjera të informacionit;
4. Ndërveprimi me vetveten, me njohuritë, me qëndrimet paraparake dhe informacioneve të reja si rezultat i informacioneve të përpunuara në shumë mënyra.

Ndërsa, bazuar tek autori Shahini gjejmë disa teknika të cilat sugjerohen si teknika efektive për të mësuarin aktiv:

*Teknika “mendo-puno në grup-ndaj”* (think-pair-share). Këtu nxënës punojnë në mënyrë individuale për një kohë të shkurtër, pastaj ndahen në grupe, rishikojnë dhe përmirësojnë përgjigjet e tyre. Në fund, i ndajnë përfundimet me klasën. Kjo strukturë, kërkon pak më shumë kohë sesa një aktivitet i thjeshtë në grup, por përfshin të menduarin individual dhe çon në një të nxënë më të përgjithshëm.

*Teknika e grupeve bashkëpunuese në marrjen e shënimeve* (cooperative note-taking pairs). Nxënësit, në këtë metodë formojnë grupe për të punuar së bashku gjatë klasës pas një segmenti të shkurtër leksioni, ata i përmbledhin shënimet palës tjetër. Ndërsa pala tjetër shton ose përmirëson ose korrigjon informacionin. Kjo metodë ka për qëllim përmirësimin e mbajtjes shënim të njohurive në klasë.

*Teknika e pyetësorëve reciprokë të udhëhequr* (guided reciprocal peer questioning). Nxënësit ndahen në grupe prej tre ose katër vetash dhe punojnë me një listë pyetjesh të përgjithshme. Çdo nxënës përgatit dy ose tre nga këto pyetje që provokojnë mendimet në varësi të përmbajtjes së shpjeguar në klasë. Këto pyetje janë të hartuara për të inkurajuar aftësitë e të menduarit në nivel më të lartë (Shahini, 2013). Pyetjet më vonë diskutohen në grupe të vogla në fillim të klasës dhe e gjithë klasa diskuton në vijim pyetjet, të cilat ishin më interesante në diskutimet e grupit.

*Teknika e provimit të koncepteve* (concept tests), këtu u paraqitet nxënësve një listë me pyetje konceptuale që kanë shumë përgjigje, disa prej tyre janë si shpërqendruar që reflektojnë keqkuptimet apo konceptimet e gabuara të nxënësve.

Ata fillimisht i përzgjedhin përgjigjet në mënyrë individuale dhe pastaj vihen në grupe dhe *diskutojnë se pse përgjigjet e gabuara ishin të gabuara.*

*Teknika e esesë një minutëshe (one minute paper),* tregohet si një teknikë shumë efektive për të matur përparimin e nxënësve si në kuptimin e materialit ashtu në reagimin e tyre ndaj tij. Autori percepton rëndësinë e kësaj teknike, kur mësimit kërkohet nga nxënësit të nxjerrin një fletë të bardhë bosh, jep një pyetje dhe një minutë për t'u përgjigjur.

Në anën tjetër, kjo është një mënyrë që të kuptoni nëse nxënësit po e shohin dhe kuptojnë materialin që po shpjegoni ashtu si duhet. Një variant tjetër i kësaj eseje një minutëshe, përveç shkrimit të pikave të qarta, është ai i shkrimit të pikave të paqarta (Shahini, 2013). Këtu u jepet nxënësve më shumë kohë për t'u përgjigjur pyetjes se cila ishte pika më e paqartë në lidhje me konceptin e prezantuar në klasë. Kështu, herën tjetër, mësimi fillohet me adresimin e pyetjeve të paqarta nga këto ese një minutëshe dhe sqarimin e tyre.

*Teknika e ditarit (daily journal).* Kjo kombinon avantazhet e metodave të mësipërme dhe lejon për një diskutim më të thellë dhe për reagimin ndaj materialit të paraqitur në orën e mësimit. Për këtë konsiderohet e nevojshme të lihet një sasi kohe në klasë në mënyrë që nxënësit të plotësojnë ditarin ose u jepet si detyrë shtëpie. Kjo lejon për ngritjen e pyetjeve më komplekse, të cilat jo vetëm marrin njohuritë por edhe reagimin apo qëndrimin e nxënësve ndaj problemeve të paraqitura.

*Teknika e të menduarit me zë të lartë gjatë zgjidhjes së problemit në grup.* Kjo është një teknikë e fuqishme që i ndihmon studentët gjatë zgjidhjes së një problemi, analizës së një çështjeje, përkthimi apo interpretimi të tekstit. Studentët, zakonisht duhet të ndahen në grupe prej dy vetash, ku një luan rolin e intervistuesit e tjetri rolin e shpjeguesit.

Shpjeguesit kanë një minutë apo dy që t'u shpjegojnë problemin hap pas hapi apo paragraf pas paragrafi palës tjetër, ndërkohë që intervistuesit duhet të pyesin pyetje nëse shpjegimet janë të paqarta. Pasi mbaron koha e përcaktuar studentët ftohen që të spjegojnë gjërat profesorit (Shahini, 2013).

Në metodologjitë dhe strategjitë e reja të mësimit të bazuar në filozofinë e zhvillimit të mendimit kritik ERR (E-evokimi, R -realizimi i kuptimit dhe R -reflektimi) dhe të nxënësve ndërveprues ekzistojnë mbi 30 teknika bashkëkohore me të cilat nxënësi del në qendër të mësimit. Ndër këto teknika tashmë të njohura në praktikën tonë edukative do veçojmë: Metoda INSERT (Interaktive Noting Sistem for Effective Reading and Thinking) (Sistemi ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe për leximin e suksesshëm), Kllaster, Pesëvargëshi, Kubimi, Di/Dua të di/Mësoj, Teknika e të lexuarit në dyshe, Diskutimi dhe të nxënësve bashkëpunim, Grupet e ekspertëve (teknika Xhingsou), Diagram i Venit etj.,

## 2.4. Arsyet dhe rëndësia e përdorimit të teknologjisë në klasë

Teknologjia ka transformuar mënyrën e mësimdhënies dhe të nxënësve por duke transformuar procesin, ajo po transformon dhe rezultatin.

Në vitet e fundit, kur aplikimet e teknologjisë të tilla si video projektor, smart board, kompjuterë, software, internet, tableta, mobile etj. janë futur në sistemin e arsimit, burimet për mësimdhënie kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme (Ali, 2018). Metodistët mendojnë se ka shumë avantazhe të përdorimit të teknologjisë në klasë si për shembull: ajo e bën nxënësin më të interesuar për temën mësimore, zvogëlon kohën e të mësuarit si dhe ofron mundësi për të mësuar në mënyrë jotradicionale.

Për të kuptuar rëndësinë e teknologjisë në procesin mësimor shtrojmë pyetjen se si dhe sa përdorimi i pajisjeve kompjuterike në arsimin fillor dhe arsimin mesëm të ulët do ta stimulonte motivimin e nxënësve për të mësuar, për t'i angazhuar ata gjatë aktiviteteve të mësimdhënies dhe nxënies dhe si e sa teknologjia do të mbështeste metodat e të nxënësve.

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje e cila do të shpjegonte rolin dhe rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor, metodistët të arsimit kanë kryer studime të shumta gjatë të cilave kanë vërejtur se përdorimi i pajisjeve kompjuterike në klasë paraqet me të vërtetë përfitime të veçanta (Boachie, 2016).

Ata theksojnë se intervistat me mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe vëzhgimet në klasë tregojnë se motivimi dhe përqendrimi i nxënësve gjatë aktiviteteve të të nxënësve *rritet* kur ata përdorin pajisje kompjuterike për t'i përfunduar këto detyra. Pajisjet kompjuterike janë veçanërisht të dobishme për nxënësit e ciklit fillor gjatë shkrimit të detyrave duke stimuluar kështu aftësinë e të shkruarit (kompetencën gjuhësore), por kjo ndodh atëherë kur pajisja që përdoret ndërtohet nga një tastierë e plotë shkrimi.

Përdorimi i pajisjeve kompjuterike mbështet metodat e të nxënësve për nxënës me aftësi të ndryshme për të nxënë, kështu përdorimi i tyre ndihmon nxënësit me aftësi të ndryshme konceptuale si dhe nxënësit me nevoja të veçanta në përthithjen më të shpejtë të koncepteve të reja gjatë një teme çfarëdo mësimi. Po ashtu mësimdhënësit dhe prindërit pranojnë faktin se për shkak të përdorimit të pajisjeve kompjuterike nxënësit dhe fëmijët e tyre e përdorin më me efikasitet kohën e tyre të punës (Ross, 2010).

Përdorimi i teknologjisë në klasë gjithashtu ka një efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve pasi ata ndjehen më të suksesshëm, më të motivuar për të mësuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim.

Në kohën e sotme digjitale, aftësia për të aksesuar, përshtatur dhe për të krijuar aftësi e dije duke përdorur teknologjinë është kritike për suksesin e nxënësit. Të gjitha arsyet e lartpërmendura theksojnë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e përdorimit të teknologjisë gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies për të rritur efikasitetin e tij.

## 2.5. Teknologjia dhe qasja konstruktiviste e saj

*Duke përdorur së bashku teknologjinë dhe qasjen konstruktiviste mësuesi siguron integrim dhe shfrytëzim më të mirë të mjeteve të teknologjisë në klasë në mënyra të përshtatshme dhe efektive, duke i dhënë mësimdhënies/nxënies mjetin e nevojshëm për të përmirësuar metodat e mësimin të cilat kanë në fokus të tyre nxënësin (Mexhuani, 2014).*

Të besosh se vetëm përdorimi i teknologjisë dhe kompjuterit do të përmirësojë rezultatet mësimore është njësoj si të mohosh rëndësinë e kapacitetit të mendjes njerëzore. Është e qartë se kompjuteri mund të përdoret si një mjet për të lehtësuar mësimdhënien dhe nxënien, megjithatë, po aq e qartë është që ai (makina) nuk mund të bëjë zgjedhjen e qasjes pedagogjike, se çfarë qasje duhet të përdoret gjatë orës së mësimin për arritjen e rezultateve të dëshiruara të të nxënies; mësimdhënësi e vendos vetë.

### ***Si duhet të përdoret teknologjia në procesin mësimor për të arritur rezultatet e dëshiruara mësimore?***

Teknologjia mund ta ndihmojë dhe e ndihmon nxënësin të zhvillojë të gjitha llojet e aftësive nga ato më të thjeshtat deri te ato më të ndërlikuarat (Henry, 2011). Megjithatë, ***që teknologjia të jetë e suksesshme***, mësimdhënësi duhet të bëjë zgjedhje të informuara në lidhje me *qasjen pedagogjike, nevojat e nxënësit dhe rezultatet e të nxënies*. Për mësimdhënësin, sa e rëndësishme është të dijë *se për çfarë do ta përdorë teknologjinë*, po aq e rëndësishme është të dijë dhe *mënyrën se si e nxëna mund të përmirësohet përmes teknologjisë*.

Integrimi i teknologjisë në klasë nënkupton shumë gjëra për mësues të ndryshëm. Kur mësimdhënësit pyeten se a e integrojnë teknologjinë në lëndët e tyre ata japin përgjigje të shumta të tilla si:

- *E përdor kompjuterin në klasë për të përforcuar çështjet që unë kam shpjeguar.*
- *Nxënësit e përdorin kompjuterin për të gjetur informacion.*
- *Nxënësit e mi përdorin word-in për të kryer detyrat e shtëpisë.*
- *Përdor power –pointin për të bërë prezantime në klasë.*



Por a janë këta shembuj të integrimit të teknologjisë? Dikush mund të mendojë se secili prej këtyre shembujve integron teknologjinë në klasë.

Por çështja e vërtetë nuk qëndron në faktin nëse teknologjia përdoret në klasë, por nëse ajo po përdoret për të përmirësuar procesin e të nxënës.

Teknologjia nuk të garanton mësimdhënie/nxënie të dobishme, madje përdorime të papërshtatshme të saj mund ta bëjnë të nxënës më të vështirë. Ky është rasti për shembull kur nxënësi shpenzon më të shumtën e kohës për selektimin e shkrimit dhe zgjedhjen e ngjyrave në detyrat e tij në vend që të planifikojë, të shkruajë dhe të rishikojë idetë e tij lidhur me detyrën e dhënë.

Megjithëse për integrimin e teknologjisë flitet shumë, pak mësimdhënës kanë një vizion apo filozofi të qartë për mënyrën e integrimit të saj në kurrikul me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënës (Boachie, 2016). Tri pyetje ndihmojnë mësimdhënësin për të përcaktuar meritat e teknologjisë në një orë mësimi apo në një situatë të caktuar.

Ato janë:

- A është përmbajtja mësimore e vlefshëm? (A janë rezultatet e të nxënës të qarta, të lidhura me kompetencat kyçe dhe nivelet e arritjes së nxënësve)
- A e angazhojnë nxënësin aktivitetet e përzgjedhura mësimore?
- Sa e ka përmirësuar teknologjia mësimin në mënyrë që pa të, nuk do të ishte e mundur?

Mësimdhënësit duhet të jenë kompetent në lidhje me dijet, aftësitë dhe qëndrimet që ai dëshiron t'u mësojë nxënësve, po aq sa dhe vëzhgues i aftë i mjedisit në të cilin nxënësit ndërtojnë dijet dhe ndërveprojnë me njëri tjetrin. Për këtë qëllim, filozofia e arsimit dhe qasja arsimore luajnë një rol të rëndësishme në kornizën teorike të integrimit të teknologjisë për përmirësimin e orës mësimore.

Për t'u siguruar se mjetet e teknologjisë janë përdorur në mënyrë efektive mësimdhënësit duhet t'i përdorë ato nëpërmjet zbatimit të teorive të përshtatshme të mësimdhënies. Filozofia e kurrikulës së re të arsimit bazë është bazuar në qasjen konstruktiviste. Kjo qasje përkufizon: "të mësuarit ndodh kur personi ndërton së bashku mekanizmin për të mësuar dhe versionin e tij unik të dijeve, plotësuar këto me përvojat dhe aftësitë e tij personale" (Darren, 2017). Sipas kësaj qasjeje dija ndërtohet, nuk transmetohet ndaj nxënësi gjeneron dije të reja nëpërmjet aktiviteteve, përvojave dhe eksperimenteve.

Qasja konstruktiviste me fokus nxënësin në qendër, nxit përfshirjen e nxënësit në procesin e ndërtimit të dijeve dhe kërkon mënyra që mësimdhënësit të jetë lehtësues në procesin mësimor dhe jo të diktojë informacionin. Kjo qasje dukshëm lidhet më mirë me integrimin e teknologjisë.

P.sh mësimi zbulues si një formë e qasjes konstruktiviste inkurajon angazhimin aktiv, nxit motivimin, autonominë, përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e nxënësit.

Nxënësi udhëzohet nga mësimdhënësi, të bashkëveprojë dhe kryejë eksperimente për ta ndihmuar atë të ndërtojë dije dhe aftësi duke u nisur nga dijet dhe aftësitë paraprake.

Detyra e mësimdhënësit është të bashkërendojë informacionin e duhur në një mënyrë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të jenë komponentë thelbësorë për të ndihmuar nxënësin të shohë se si konceptet zbatohen në situata reale. Kjo i jep mundësi nxënësit për të eksploruar mjedise më komplekse.

Një shembull i përdorimit të teknologjisë janë simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike ku nxënësit luajnë rolin e vendimmarrësit në situata historike në mënyrë që të shikojnë rëndësinë e këtyre ngjarjeve në jetën e tyre të përditshme dhe të zhvillojnë më mirë aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit (Affin, 2018). Forma të tjera të përdorimit të teknologjisë janë dhe udhëtimet virtuale në kohë. Nxënësit mësojnë rreth kulturave të ndryshme duke parë fotografi, filma, videoklipe, prezantime në power-point dhe tekste të përzgjedhura. Nxënësit, gjatë navigimit nëpër udhëtimin virtual, u përgjigjen pyetjeve të mësimdhënësit.

Duke përdorur teknologjinë në qasjen konstruktiviste mësimdhënësit e kanë më të lehtë të përfshijnë nxënësit në aktivitetet mësimore. Ata mund të krijojnë aktivitete për nivele dhe stile të ndryshme të të nxënësve si dhe mund të zgjerojnë gamën e informacioneve që janë në dispozicion të nxënësve.

Teknologjia është më shumë sesa një mënyrë tjetër/ndryshe e prezantimit të informacionit, ajo është sistemi nëpërmjet të cilit informacioni prezantohet (Darren, 2017).

Teknologjia, si pjesë e teorisë konstruktiviste të mësimdhënies, është korniza e metodologjisë së mësimdhënies/nxënies e cila siguron aftësitë për të suportuar të gjitha format kryesore të kësaj teorie.

### **2.5.1. Përdorimi i teknologjisë së komunikimit si mjet mësimor**

*Mësimdhënësit e përdorin teknologjinë e komunikimit për të nxitur shkëmbimet e informacionit me dhe ndërmjet nxënësve, për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien dhe për të nxitur mësimin bashkëveprues.*

Qasja konstruktiviste përfshin komunikimin e informacionit nga mësimdhënësi tek nxënësi, nga nxënësi tek mësimdhënësi, nga nxënësi tek nxënësi (Hossain, 2011).

Mësimdhënësi sot përballlet me një sërë zgjedhjesh të reja që kërkojnë përgjegjësi profesionale në lidhje me mënyrat e integritit të teknologjisë së komunikimit gjatë aktiviteteve mësimore në klasë dhe jashtë saj.

Teknologjitë e komunikimit janë mjete elektronike të cilat përdorin kompjuterin dhe internetin për të bërë të mundur shkëmbimin e shpejtë të informacionit ndërmjet njerëzve.

Komunikimi elektronik i njohur ndryshe dhe si komunikimi mediatic kompjuterik përfshin lloje të ndryshme të shkëmbimeve të informacionit ndërmjet njerëzve (Ali, 2018). Ekzistojnë shumë mjete të teknologjisë së komunikimit që mësimdhënësi mund të përdorë gjatë aktiviteteve mësimore të tilla si:

- ✓ **E-mail** (*posta elektronike*) dhe **chat-mesazhet e çastit** (*instant messaging (IM)*). Këto janë forma të komunikimit online që paraqesin shkëmbime të shkurtra elektronike ndërmjet individëve si: mësimdhënës-nxënës, mësimdhënës-prindër, mësimdhënës dhe personel drejtues.
- ✓ **Website i mësuesit** ose website i klasës është faqe interneti që ndërtohet nga mësimdhënësi për të paraqitur orë mësimi dhe për të komunikuar informacione për nxënësit, prindërit, shkollën dhe personelin arsimor.
- ✓ **Blogje** (*ditar/lajme*) janë revista/ditar publike online të aksesueshme shkruar nga individë (si mësimdhënës) për të tjerët (si nxënës, prindër dhe mësimdhënës të tjerë) për tu lexuar dhe komentuar prej tyre.
- ✓ **Diskutimet online** janë forume elektronike ku mësimdhënësit dhe nxënësit diskutojnë për çështje të ndryshme arsimore. Diskutimet online janë komponent i zakonshëm i blog-eve dhe websiteve të mësuesve.
- ✓ **Wikis** (do të thotë i shpejtë) janë faqe interneti që mësimdhënësit dhe nxënësit i krijojnë së bashku duke lexuar dhe rishikuar idetë dhe komentet e njëri-tjetrit.

Mësimdhënia dhe nxënia është një proces nëpërmjet të cilit nxënësit ndërveprojnë me njëri tjetrin. Mesazhet, blog-et, wikis përdoren për të krijuar një mjedis online që të mësojnë nxënësit (Charlotteaux, 2009). Në këtë mjedis, nxënësit komunikojnë, diskutojnë dhe përdorin njohuritë e njëri tjetrit për të ndërtuar dijet nëpërmjet informacionit të mbledhur nga ata vetë si dhe për të gjetur zgjidhje rreth problemeve të ndryshme që shfaqen gjatë aktiviteteve të të nxënës.

Teknologjia e komunikimit, pjesëmarrja dhe bashkëveprimi në grup i motivon ata për të mësuar. Një hap thelbësor për mësuesin është ndërtimi i sistemit të komunikimit të informacionit, një proces që mund të krahasohet me përshtatjen apo përzgjedhjen e komponentëve të duhur për një mësimdhënie atraktive dhe cilësore (Affin, 2018).

Ashtu si mësimdhënësi zgjedh metodologjinë e duhur dhe efektive për të arritur rezultatet e dëshiruara të të nxënit, ashtu ai duhet të përzgjedhë dhe komponentët e opsionet më të mirë të teknologjisë së komunikimit të informacionit të cilat përmirësojnë metodologjinë e mësimdhënies dhe përshtaten më së miri me nevojat e nxënësve.

### **2.5.2. Zhvillimi i orës së mësimit duke përdorur teknologjinë**

*Në një botë digjitale asnjë organizim nuk mund të arrijë rezultate pa përfshirjen e teknologjisë në çdo aspekt të praktikave të përditshme. Është koha e shkollës të maksimizojë sa më mirë impaktin e teknologjisë gjatë procesit mësimor (Goode, 2014).*

Zhvillimi i mësimit u referohet të gjitha aktiviteteve që mësimdhënësit bëjnë dhe krijojnë për të ndërtuar dije dhe për të vlerësuar nxënësit nëse i kanë përvetësuar këto dije.

Zhvillimi i mësimit përfshin vendimet e mësimdhënësit rreth tri elementeve të ndërlidhura të mësimdhënies/nxënies:

- Përmbajtja akademike (çfarë duhet të mësojnë nxënësit).
- Qëllimet mësimore (rezultatet e të nxënit), metodat dhe procedurat (se si ta japim përmbajtjen akademike).
- Vlerësimi i rezultateve të të nxënit (si ta dimë se çfarë nxënësit kanë përvetësuar).

Zhvillimi i mësimit duke përdorur teknologjinë lidhet me faktin se si mësimdhënësit përdorin burimet elektronike për të lehtësuar dhe për të përmirësuar procesin e mësimdhënies/nxënies.

### **2.5.3. Përmbajtja mësimore/akademike**

Për çdo orë mësimi mësimdhënësit zgjedhin përmbajtjen mësimore/akademike-faktet, konceptet, idetë, dijet dhe aftësitë që ata duan të transmetojnë e ndajnë me nxënësit. Qartazi korniza kurrikulare e AP, kurrikula bërthamë dhe kurrikulat lëndore (programet) përkufizojnë dhe udhëzojnë “çka duhet mësuar”.

Zhvillimi i mësimit duhet të lidhet me përmbajtjen kurrikulare dhe rezultatet e të nxënit për nivelet e arritjes së nxënësit. Megjithatë, për shkak se nuk ka kurrikul e cila parashikon gjithçka që duhet t’u mësosh nxënësve në lidhje me temën mësimore, mësimdhënësit duhet të bëjnë zgjedhje për atë që do të hulumtojnë dhe do t’u shpjegojnë nxënësve çdo ditë.

**Teknologjia** luan një rol kryesor në ndihmë të mësimdhënësit për t’iu përgjigjur pyetjes se "Çfarë duhet të japin mësimit?", për të përzgjedhur materialin mësimor/akademik dhe për të zgjeruar përmbajtjen mësimore/akademike.

Përmbajtja digjitale e disponueshme në internet përfshin një koleksion të gjerë burimesh informacioni për çdo kurrikul lëndore (Boachie, 2016). Duke përdorur kërkimin në internet, materiale të shkruara, database të dhënash, enciklopedi online, blogs, wikis, janë të aksesueshme për mësime dhe nxënës si forma të reja dhe të shumta për marrjen dhe gjetjen e informacionit në lidhje me përmbajtjen mësimore/akademike që duhet dhënë në një orë çfarëdo mësimi.

#### 2.5.4. Rezultatet e të nxënit, metodologjia dhe procedurat në lëndën e teknologjisë

Pasi mësime dhe nxënës i përgjigjen pyetjes se "Çfarë duhet të japin mësim?" mësime dhe nxënës vendosin për mënyrën se "Si do ta japin mësimin?". Ata përcaktojnë rezultatet e të nxënit që duhet të arrijnë gjatë orës së mësimi, metodat dhe procedurat që do t'i përdorin në orët e tyre mësimore për arritjen e rezultateve të nxënit (Ali, 2018). Rezultatet e të nxënit janë arsyeja pse një mësim po mësohet.

**Metodat** janë strategji të ndryshme mësimore për grupe të vogla apo të mëdha nxënësish që mësime dhe nxënës përdorin për të përcjellë përmbajtjen/mësimore akademike për nxënës. Metoda më të shpeshta që mësime dhe nxënës përdorin gjatë orës së mësimi janë: diskutimi, loja me role, simulimi, studim rasti, aktivitete të bazuara në hetim, shkrimi kreativ, mësimi reflektues, ushtrime, lojëra.

**Procedurat** janë aktivitete të planifikuara nga ana e mësime dhe nxënës për t'u zhvilluar gjatë një ore mësimi, duke përfshirë dhe grupimin e nxënësve dhe se sa kohë merr çdo aktivitet për t'u zhvilluar. Mësime dhe nxënës kombinojnë rezultatet e të nxënit, metodat, dhe procedurat në formatet e tyre të planifikimit ditor. Ndonjëherë përmbajtja kurrikulare dikton këto procese, ndonjëherë rezultatet e të nxënit, metodat dhe procedurat diktojnë zgjedhjen e përmbajtjes. Por mund të themi që përmbajtja, rezultatet e të nxënit, metodat dhe procedurat reciprokisht mbështesin njëra-tjetrën në një proces dinamik të zhvillimit të orës së mësimi, ku teknologjia mbështet në mënyra të ndryshme këtë proces.

Teknologjitë më të shumta që mbështesin procesin e të nxënit janë: (Boachie, 2016)

- *Software prezantimi (Presentation software)*
- *Software të mendimit vizual (Visual thinking software)*
- *Web-me bazë diagram dhe mjete të krijimit të diagramave (Web-based diagram- and flowchart-making tools)*

- *Faqe interneti të zhvilluara nga mësime dhënësi (Teacher-developed websites)*
- *Diskutime temash dhe email-i (Threaded discussions and email)*
- *Link-e, blöge dhe wikis (Podcasts, blogs, and wikis)*
- *Software interaktivë (Interactive software)*
- *Webquest*
- *Sisteme inteligjente për mësime dhënie (Intelligent tutoring systems)*
- *Kamera digjitalë dhe software për krijimin e filmave (Digital cameras and movie-making software)*
- *Teknologji ndihmëse (Assistive technologies).*

### 2.5.5. Vlerësimi i të nxëniet

Vlerësimi i mësime dhënies/nxënies (rezultateve të të nxëniet) ndodh para, gjatë, dhe pas mësime dhënies/nxënies duke ndihmuar mësime dhënësit të vlerësojë së sa janë arritur rezultatet e të nxëniet përcaktuar për atë orë mësimore nëpërmjet vlerësimit të performancës së nxënësve. Vlerësimi mund të jetë përmbledhës (përmbledh atë që nxëniet kanë mësuar në fund të një ore mësimi), formues (ndodh gjatë gjithë kohës) ose diagnostikues (i paraprin një mësimi si një mënyrë për të matur atë që nxënësi paraprakisht di).

Mjetet/instrumentet e vlerësimit përfshijnë pyetjet me zgjidhje të shumëfishta, mini- teste, ese, detyra me shkrim, diskutime, vëzhgimet e mësime dhënësit, aktivizimin e nxëniet në klasë, projekte, portofolin e nxëniet dhe performancën e nxëniet (Avdiu, 2013). Këto instrumente vlerësimi sigurojnë të dhënat mbi atë çka nxëniet dinë dhe janë në gjendje të bëjnë si rezultat i mësime dhënies/nxënies.

Mjetet e teknologjisë që mbështesin procesin e vlerësimit dhe vlerësimin e nxënësve janë:

- *Teste elektronike dhe kuiz-e*
- *Portofoli digjital*
- *Rubrika vlerësimi online*
- *Anketime online.*

## **2.6. Kompetencat e mësimit për realizimin e situatave të nxënies me bazë teknologjike në orën mësimore**

Roli i mësimit në klasat konstruktiviste nuk është i njëjtë me rolin e mësimit në klasat bihevjoriste. Në klasat konstruktiviste mësimit përdor shpesh edhe teknologjinë për realizimin e situatave të nxënies në orën mësimore. Integrimi i TIK-ut në procesin mësimor nuk kufizohet thjesht me instalimin e rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike (Darren, 2017).

Ai përfshin përdorimin e të gjitha teknologjive që ofrojnë këto pajisje në shkollë për të përmirësuar mësimitin dhe për të lehtësuar mësimitin në këtë proces.

Njohuritë bazë që duhet të zotërojnë mësuesi i shekullit të 21-të përfshijnë edhe përdorimin e teknologjive të informimit dhe komunikimit e, veçanërisht, kompjuterin dhe web-teknologjitë, si metodologji në procesin mësimor (Ali, 2018). Këto metodologji ofrojnë një mjedis dhe një qasje më efektive në procesin mësimor.

Sipas shumë autorëve të huaj dhe vendas, përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor ka ndryshuar jo vetëm metodat e mësimit, po edhe të mësimit. Integrimi i përdorimit të TIK-ut në programet shkollore sjell ndryshime në cilësinë e procesit mësimor. Në dokumentet e reja kurrikulare të hartuara në kuadër të rishikimit të kurrikulës aktuale për sistemin tonë arsimor, kompetenca digjitale është një ndër shtatë kompetencat kyçe të kurrikulës. Kjo kompetencë nënkupton aftësinë për përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë dhe gjatë kohës së lirë. Ajo bazohet në shkathtësimin e përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet (Affin, 2018).

Aplikimi i TIK-ut në klasë ofron rritjen e cilësisë së mësimit. Roli i mësimit tashmë synon të ndryshojë nga ajo e përcësimit të njohurive në atë të ndërtuesit të njohurive, trajnerit, dhe krijuesit të mjediseve mësimore të ngjashme me ato të situatave reale. Megjithatë përdorimi i TIK-u kërkon, që si mësuesit ashtu edhe nxënies të jenë në gjendje të përdorin teknologjitë e reja për grumbullimin, menaxhimin, përzgjedhjen dhe vlerësimin e informacionit për zgjidhjen e problemeve dhe vënien në jetë të ideve praktike inovatore. Që mësimit ta luajë këtë rol, duhet që minimalisht ai të zotërojë kompetencat e përcaktuara në dokumentet zyrtarë të Unescos (UNESCO, 2011), për teknologjinë në arsim (moduli 4 në konferencën e Unescos).

Për të kryer operacionet bazë me hardware dhe software si dhe aplikimet e menaxhimit të informacionit mësimdhënësi duhet :

- të përshkruajë dhe demonstrojë përdorimin e tipeve të ndryshme të hardware-eve, kompjuterave, laptopëve, printerave, skanerave dhe pajisjeve portabël;
- të përshkruajë dhe demonstrojë funksionet bazë dhe të përdorë word processorët;
- të përshkruajë dhe demonstrojë qëllimin dhe cilësitë kryesorë të software-ve të prezantimit dhe resurseve të tjerë digjitale;
- të përshkruajë qëllimin dhe funksionimin e software-eve grafike dhe të përdorë një paketë software-ike grafike;
- të përshkruajë Internet-in dhe World Wide Web, si dhe të tregojë si funksionon një browser (shfetes) ose si përdoret URL për të aksesuar një website;
- të përdorë një motor kërkimi (search engine) të demonstrojë kërkimin e website eve;
- të krijojë një llogari e-mail-i dhe ta përdorë atë;
- të përshkruajë funksionimin e një software-i ose një pakete (software packages) mbi një fushë specifike;
- të lokalizojë dhe skedojë paketat software-ike të edukimit dhe t'i vlerësojë ato për nga saktësia dhe përputhja me kurrikulën shkollore;

### **2.6.1. Planifikimi i një situatë të nxëni duke përdorur TIK-un**

Për planifikimin e situatave të të nxënit duke përdorur teknologjinë, mësimdhënësit mund të përdorin ilustrime/demonstrime të ngjashme me ato të botës reale gjatë mësimdhënies. Në shkollat tona kemi dy kategorive mësuesish:

- a. mësimdhënës që kanë njohuri fillestare të domosdoshme për përdorimin e kompjuterit dhe Internetit, sipas kërkesave të UNESCO-s (UNESCO, 2011), dhe
- b. mësimdhënës të avancuar në përdorimin e kompjuterit dhe Internetit duke përfshirë këtu edhe njohuri nga programimi në gjuhën Java ose minimalisht në gjuhën C++ (ka shumë ngjashmëri midis gjuhës Java dhe asaj C++).

Për kategorinë a) të mësimdhënësve, do të këshillojmë që:

Së pari, në përshtatje me tematikën e mësimit që duan të ilustrojnë, mësimdhënësit duhet të bëjnë një kërkim në Internet me fjalë kyçe “tema e mësimdhënësit (anglisht) + Java Applet ose Visualization”. Pasi të gjejnë faqet, që mund të jenë disa, të zgjedhin ato faqe për të cilat demonstrimi/vizualizimi është më i përshtatshëm për temën që trajtojnë.



Pastaj ato duhet të shkarkojnë (download) faqen lokalisht, duke shkarkuar jo vetëm skedarin (faqen) .htm ose html, por edhe të gjithë skedarët që link-ohen në faqe. Në veçanti, duhet shkarkuar edhe skedari i applet-it (nëse ka të tillë) emri.class.

Pasi provon nëse faqja hapet lokalisht (duke shkëputur kompjuterin nga Interneti), e hap atë dhe shikon me “ View Page Source” (komanda varet nga lloji i browser-it që përdoret) faqen burim *emri.html*, e cila është një skedar i formatit ASCII (thjesht tekst-pa simbole apo formula). Ky skedar editohet me anë të aplikimit “Notepad” ose “Wordpad”. Teksti i faqes html është shkruar në gjuhën HTML, pra me komanda që shkruhen brenda etiketave (Ali, 2018).

Për të përshtatur tekstin në shqip, mjafton të zëvendësohet teksti anglisht me atë shqip, por gjithnjë në modën ASCII.

Ndryshimet e kryera ruhen dhe pastaj rishfaqet me anë të browser-it skedari i ndryshuar.

## 2.6.2. Struktura e një matrice të situatës së të nxënimit me bazë TIK-un

Në tabelën e mëposhtme është dhënë struktura e matricës së situatës së të nxënimit me bazë TIK-un. Duke u mbështetur në rubrikat e kësaj matrice janë ndërtuar situatat e të nxënimit për disa lëndë të arsimit fillor (klasa 1) dhe arsimit të mesëm të ulët (klasa 6), (Boachie, 2016).

**Tabela 1. Matrica e situatës së të nxënimit me bazë Tik-un**

Situata e të nxënimit	Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave	Veprimet në situatë	Burimet	Vlerësimi
Shembuj situatash të të nxënimit me bazë TIK-un.	Përshkruhen rezultatet e pritshme sipas kompetencave që duhet të zotërojë nxënësi në përfundim të orës mësimore.	Përshkruhen hapat që duhet të ndjekë mësimdhënësi dhe nxënësi gjatë orës mësimore për ndërtimin e njohurive të reja të reja me ndihmen e teknologjisë	Burime të ndryshme për trajtimin e këtyre situatave si dhe link-et që duhet të përdoren.	Pritshmëritë e mësuesit për nxënësit në përfundim të situatës.

Në ndihmë të realizimit të këtyre situatave, jepen shpjegimet e mëposhtme:

**a) Situata duke përdorur TIK-un është:**

- një situatë e ngjashme me ato të jetës reale, në të cilën vizualizohet një dukuri apo eksperiment që përdoret nga nxënësit sipas udhëzimeve të mësuesit.

Këtu shkruhet tema e situatës dhe bëhet një përshkrim i rrethanave të saj.

**b) Veprimet përmbajnë:**

- Hapat që duhet të ndjekë nxënësi për trajtimin e situatës;
- Metodatat e trajtimit të situatës;
- Pyetjet për diskutim rreth kuptimit të situatës (Ali, 2018)

Këtu shkruhen veprimet e mundshme që do të kryejnë nxënësit për trajtimin e situatës, metodatat e punës, mënyrat dhe teknikat e shfrytëzimit të link-eve të shkarkuara nga interneti.

**c) Burimet:**

- burime vetjake të nxënësve: ata janë kognitive (njohuritë paraprake të nxënësit), konative (elementet emocionale, motivuese etj.) dhe trupore;
- burime specifike të situatës: link-et që shkarkohen nga interneti për demonstrimin e një situatë të ngjashme me atë të kushteve reale;

Këtu përfshihen njohuritë paraprake të nxënësve, të nevojshme për trajtimin e situatës, qëndrimet, vlerat dhe veçoritë e tyre që lidhen me gjithpërfshirjen e nxënësve në trajtimin e saj.

**d) Vlerësimi**

Rubrika e vlerësimit saktëson:

- tipin e trajtimit të pritshëm që situata të trajtohet realisht nga nxënësi dhe të pranohet nga të tjerët.
- kriteret e vlerësimit të trajtimit kompetent të situatës nga nxënësit (Darren, 2017).

Për konceptimin dhe shkrimin e një situatë, mësuesi ndjek formatin e mëposhtëm.

### **2.6.3. Formati i situatës së të nxënit**

*Në planifikimin e një situatë të nxëni me bazë TIK-un, mësuesi merr parasysh:*

1. Rezultatet e të nxënit (rezultatet e të nxënit të programit që realizohen nëpërmjet kësaj situatë).
2. Emërtimin e situatës (titulli i situatës).
3. Përshkrimin kontekstual të situatës (përmbajtja e situatës në kontekstin e realizimit të rezultateve të të nxënit).
4. Veprimet e kryera për trajtimin e situatës.
5. Burimet (mjete, pajisje, burime të ndryshme, linqet e përdorura, njohuritë dhe aftësitë paraprake të nxënësve).
6. Vlerësimin (kur situata quhet e realizuar).

### **3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Metodologjia e përdorur në këtë punim është në funksion të realizimit të këtij qëllimi. Ajo kombinon të dhënat primare me ato sekondare. Të dhënat primare janë të dhëna të mbledhura nga hulumtuesi, ndërsa ato sekondare janë të dhëna të mbledhura nga të tjerët por jo për hulumtimin tonë, por të cilat mund të na shërbejnë edhe neve.

Si model i hulumtimit është zgjedhur modeli kuazi-eksperimental. Me anë të këtij modeli kam bërë krahasimin e rezultateve ndërmjet nxënësve.

Literatura është siguruar nga kërkimet e ndryshme elektronike dhe organizata të ndryshme që e kanë trajtuar këtë fenomen, si dhe nga një sërë burimesh të tjera që kanë shërbyer për të plotësuar pjesën teorike të punimit.

#### **3.1. Mostra**

Popullacioni i përfshirë në këtë hulumtim janë 89 nxënës të tri klasë të shtata në shkollën fillore të mesme të ulët “Abdullah Shabani” në Mitrovicë, ku 54 prej tyre janë meshkuj ndërsa 35 femra. Nxënësit i takojnë moshave 12-14vjet, gjegjësisht janë nxënës të klasave të shtata. Poashtu në hulumtim janë përfshirë edhe disa mësimdhënës të fushës së teknologjisë. Meqë janë marrë për hulumtim tri klasë, njëra prej tyre është përdorur si grup kontrolli, ndërsa dy klasa të tjera si grup eksperimental.

Fillimisht është realizuar një paratest për formën përkatëse, ndërsa pastesti është realizuar vetëm për grupin eksperimental.

#### **3.2. Instrumentet**

Një nga strategjitë e kërkimit të përdorura për realizimin e studimeve është ajo e mbështetur në pyetësin si instrument vëzhgimi i cili është një nga teknikat e mbledhjes së të dhënave që i përkasin kësaj strategjie. Për grumbullimin e të dhënave për këtë hulumtim si instrument kam përdorur paratesti, pastesti, pyetësin dhe lista e kontrollit.

Pyetësin është i formuluar me pyetje që i janë përshtatur natyrës së këtij hulumtimi. Paratesti është realizuar për të parë nivelin e njohurive aktuale ndërsa pastesti ka shërbyer si instrument matës i njohurive të fituara pas përdorimit të metodës puna në grupe te grupi eksperimental, gjegjësisht pas shpjegimit të njësive me metoda konvencionale për grupin e kontrollit.

Në fund të testimit të dy grupeve, është realizuar pyetësori vetëm me grupin eksperimental për të hulumtuar dhe krahasuar përshtypjet, qëndrimet dhe bindjet e nxënësve nga përvoja e tyre. Pyetësori i nxënësve përmbanë 10 pyetje, poashtu edhe i mësimdhënësve. Qëllimi i pyetësorit vë në dukje opinionin dhe qëndrimin e nxënësve dhe mësimdhënësve ndaj metodave të punës në grupe.

### **3.3. Procedurat**

Pyetësorët janë të përpiluar dhe janë përshtur për nivelet përkatëse të mostrës. Për plotësimin e tyre nga nxënësit e shkollës fillore të mesme të ulët “Abdullah Shabani” të Mitrovicës është marrë paraprakisht leje nga drejtoria e shkollës.

Pyetësorët janë shpërndarë nëpër klasë, ku poashtu është marrë edhe pëlqimi i nxënësve si pjesëmarrës në hulumtim. Para shpërndarjes së pyetësorëve nxënësit i kam njoftuar me natyrën dhe qëllimin e këtij hulumtimi, nxënësit janë siguruar për anonimitetin e përgjigjeve të tyre si dhe i kam lutur që përgjigjet e tyre të jenë të sinqerta. Kohëzgjatja e plotësimit të pyetësorit ka qenë 10–15 minuta. Në fund, është aplikuar lista e kontrollit për një tjetër pasqyrim të të arriturave të nxënësve nga ana e mësimdhënësit.

Të dhënat janë paraqitur ndërmjet programit aplikativ MS Excel. Për analizimin e të dhënave kam përdorur tabelat dhe diagramet për të përshkruar të dhënat të nxjerrura nga hulumtimi. Përmes grafikoneve kam pasqyruar edhe të dhënat e natyrës cilësore të nxjerrura nga pyetësori i realizuar, ndërsa përmes tabelës kam shfaqur të dhënat e fituara nga lista e kontrollit.

### **3.4. Rezultatet e pritura nga hulumtimi**

Rezultatet në këtë hulumtim janë të ndërthurrura me analizën dhe interpretimin e të dhënave mbi fushën e studimit, ku rezultatet e nxjerrura nga rasti i studimit kanë të bëjnë me efektin e punës në grupe gjatë procesit mësimor ku pretendohet ngritja e cilësisë së nxënies në lëndën e teknologjisë, andaj këto rezultate e përbëjnë thelbin e qëllimeve kryesore të këtij punimi, kështu duke u bazuar edhe në hipotezën dhe pyetjet ndihmëse të cilat janë formuluar dhe të cilat janë ngritur për verifikim.

Të gjitha këto kanë shërbyer si dëshmi për një praktikë të mirë të përdorimit të mësimin të bazuar në formën e punës në grupe, do të mund të jetë e pranuar dhe që mësimdhënësit e shkollave tjera të mund t’a përdorin këtë formë gjatë procesit mësimor dhe që të japin efektin maksimal të mundshëm.

## IV. REZULTATET E HULUMTIMIT

### 4. Përpunimi dhe analiza statistikore e të dhënave


Të dhënat janë analizuar sipas metodës së analizës dhe krahasimit. Të dhënat e nxjerra janë përpunuar përmes programit aplikativ EXCEL.

#### 4.1. Paratesti i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3

Rezultatet e arritura të nxënësve nga paratesti, të paraleleve të cilat kanë marr pjesë në këtë hulumtim janë: VII/1, VII/2 dhe VII/3, me numër të përgjithshëm të nxënësve 89.

Nga klasa VII/1 kemi gjithsej 28 nxënës dhe të dhënat i kemi paraqitur në diagram:

Shkëlqyeshëm	3
Shumë mirë	3
Mirë	7
Mjaftueshëm	13
Pamjaftueshëm	2
<b>Gjithsej nxënës</b>	<b>28</b>




Grafiku 1. Suksesi i përgjithshëm i paratestit të paraleles VII-1

Nga rezultati i paratestit për klasën VII/1 kanë arritur rezultat pozitiv, 81.4% pozitiv dhe 18.6% rezultat negativ, shkëlqyeshëm 11%, shumë mirë 11%, mirë 25%, mjaftueshëm 46%, pamjaftueshëm 7% dhe me 64% sa i përket notës mesatare.

Nga klasa VII/2 kemi gjithsej 30 nxënës dhe të dhënat i kemi paraqitur në diagram:

Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	8
Mirë	4
Mjaftueshëm	7
Pamjaftueshëm	1
<b>Gjithsej nxënës</b>	<b>30</b>




Grafiku 2. Suksesi i përgjithshëm i paratestit të paraleles VII-2

Nga rezultati i paratestit për klasën VII/2 kanë arritur rezultat pozitiv, 96.67% pozitiv dhe 3.33% rezultat negativ, shkëlqyeshëm 33.33%, shumë mirë 26.68%, mirë 13.33%, mjaftueshëm 23.33%, pamjaftueshëm 3.33% dhe me 72% sa i përket notës mesatare.

Nga klasa VII/3 kemi gjithsej 31 nxënës dhe të dhënat i kemi paraqitur në diagramin e radhës:

Shkëlqyeshëm	9
Shumë mirë	6
Mirë	5
Mjaftueshëm	8
Pamjaftueshëm	3
<b>Gjithsej nxënës</b>	<b>31</b>



Grafiku 3. Suksesi i përgjithshëm i paratestit të paraleles VII/3

Nga rezultati i paratestit për klasën 7/3 kemi fituar këto rezultate 90.32% rezultat pozitiv, 9.68% rezultat negativ, shkëlqyeshëm 29.03%, shumë mirë 25.81%, mirë 16.13%, mjaftueshëm 19.35, pamjaftueshëm 9.68% dhe me 68% të kalueshmërisë mesatare.




#### 4.2. Pastesti i realizuar me nxënës të klasave VII/2 dhe VII/3

Në pastest janë paraqitur rezultatet e nxënësve të cilët kanë marrë pjesë në këtë hulumtim, ku kanë marrë pjesë paralelet VII/2 dhe VII/3 me numër të përgjithshëm të nxënësve 63.

Klasa VII/2, me numër të nxënësve gjithsej 32 dhe me këto rezultate si në grafikun:

Shkëlqyeshëm	12
Shumë mirë	10
Mirë	4
Mjaftueshëm	4
Pamjaftueshëm	0
<b>Gjithsej nxënës</b>	<b>32</b>




Grafiku 4. Suksesi i përgjithshëm i pastestit të paraleles VII/2

Nga rezultatet e pastestit kemi arritur këto rezultate 100% sukses pozitiv, 40% shkëlqyeshëm, 33.34% shumë mirë, mirë 13.33%, mjaftueshëm 13.33% dhe një notë mesatare 4.


Klasa VII/3, me numër të nxënësve gjithsej 31 dhe me këto rezultate si në grafikun:

Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	9
Mirë	9
Mjaftueshëm	3
Pamjaftueshëm	0
<b>Gjithsej nxënës</b>	<b>31</b>



Grafiku 5. Suksesi i përgjithshëm i pastestit të paraleles VII/3

Nga rezultatet e pastestit kemi arritur këto rezultate 100% pozitiv, shkëlqyeshëm 32.26%, shumë mirë 29.03%, mirë 29.03%, mjaftueshëm 9.68% dhe mesatare prej 3.8.



Në diagram me ngjyrë të kuqe kemi paraqitur notën mesatare të paratestit, me ngjyrë të kaltërt kemi paraqitur pastestin si dhe me ngjyrë gjelbër kemi paraqitur diferencën. Në klasën VII/2 po e shohim se nota mesatare në paratest ka qenë 3.6 ndërsa në pastest 4 dhe diferencë 0.4.

Poashtu edhe në klasën VII/3 nota mesatare në paratest ka qenë 3.4 ndërsa në pastest 3.8 me diferencë 0.4.


Në përgjithësi kemi ngritje të suksesit, ku ka ardhur si rezultat i të mësuarit të nxënësve në grupe. Prandaj është vërtetuar hipoteza e ngritur në punim, dhe është arritur qëllimi jonë sepse këtë na argumentojnë rezultatet në këtë hulumtim të cilat janë paraqitur në grafikonet përkatëse.

### 4.3. Rezultatet e pyëtësorit i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3

Përmes pyëtësorëve të shpërndarë te nxënësit kam konstatuar sa efekt pozitiv ka puna në grupe në lënden e Teknologjisë tek nxënësit e klasave të shtata në shkollat fillore, të mesme e të ulta.

Duke u bazuar në pytjet e pyëtësorit kemi nxjerr këto rezultate:


#### 1. Sa realizohet puna ne grupe gjatë një ore mësimore?



Grafiku 6. Rezultatet nga pyëtësori me nxënës pyetja 1

Sipas rezultateve të grafikoni shohim se kemi 50% të nxënësve të anketuar të cilet janë përgjigjur pyetjes se sa realizohet puna në grupe gjatë një ore mësimor, e me disi dhe 50% janë përgjigjur shumë.


## 2. Si e bën mësimdhënësi ndarjen e grupit?



Grafiku 7. Rezultatet nga pytëtori me nxënës pyetja 2

Nga grafikoni kemi këto rezultate sa i përket pyetjes së dytë se e bën mësimdhënësi ndarjen e grupit dhe 25% e nxënësve të anktuar kanë thënë se ndarja e grupit bëhet sipas dëshires, 11% kanë thënë se zgjidhen me aktivitete në grup dhe 64% e nxënësve të anketuar kanë thënë se në secilin grup vendos një nxënës me më shumë njohuri.


## 3. Sa ju përgadit mësimdhënësi për një temë të caktuar?



Grafikoni 8. Rezultatet nga pytëtori me nxënës pyetja 3

89% e nxënësve të anketuar kanë deklaruar se mësimdhënësi i tyre i përgadit shumë për një temë të caktuar, 11% kanë deklaruar disi dhe nuk kemi asnjë përgjigje me aspak nga kjo kuptojmë se mësimdhënësit i kushtojnë shumë rëndësi përgaditjes së nxënësve të tyre.


4. Si i keni raportet ju si nxënës mes vete gjatë punës në grupe?



Grafikoni 9. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 4

Se raportet në mes të grupeve janë të mira na vërteton rezultati i grafikoni ku 93% e nxënësve të anketuar kanë thënë se janë shumë bashkpunues në grupe, 4% kanë thënë se disi janë bashkpunues dhe 3% e të anketuarve nuk janë bashkpunues në grupe.


5. Sa ndikon në përvetësimin e njohurive forma e të nxënësve në grupe?



Grafiku 10. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 5

Rezultatet nga grafikoni na tregojnë se 57% e nxënësve të anketuar kanë thënë se puna në grupe ndikon në përvetësimin e njohurive forma e të nxënësve në grupe, 43% kanë thënë se ndikon disi ndërsa me aspak nuk kemi asnjë përgjigje.

6. Sa vërehen rezultatet nga të mësuarit në grupe?



Grafikoni 11. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 6

Nxënësit e anketuar kanë deklaruar se vërehen shumë rezultatet nga të mësuarit në grupe me 57%, kurse 43% kanë thënë se rezultatet nga të mësuarit në grupe vërehen disi ndërsa nuk kemi asnjë përgjigje me aspak.

7. Sa ju motivon kjo formë e të nxënës në grupe?





Figura 12. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 7

Nga grafikoni i radhës shohim se 67% e nxënësve të anketuar kanë deklaruar se forma e të nxënës në grupe i motivon shumë, 25% i motivon disi dhe 8% e nxënësve të anketuar kanë deklaruar se aspak nuk i motivon forma e të nxënës në grupe.


8. Si vlerësoheni nga mësuesi për aktivitetin tuaj?



Grafikoni 13. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 8

67% e nxënësve të anketuar kanë thënë se vlerësohen si grup nga mësuesi i tyre, 25% vlerësohet vetëm udhëheqësi i grupit të tyre dhe 8% kanë thënë se vlerësohen në mënyrë individuale.

9. Sa jeni të kënaqur me punën e mësuesit dhe angazhimin e tyre gjatë punës në grupe?




Grafikoni 14. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 9

Shumë të kënaqur me punën e mësuesit dhe angazhimin e tyre gjatë punës në grupe janë 93% e nxënësve të anketuar, 7% janë disi të kënaqur dhe asnjë nxënës të anketuar nuk kemi me aspak të kënaqur.



**10. Sa efektive është puna në grupe?**




**Grafikoni 15. Rezultatet nga pytësori me nxënës pyetja 10**

Puna në grupe është shumë efektive dhe këtë na dëshmon rezultati i grafikoni ku shohim se 89% e nxënësve të anketuar kanë deklaruar se puna në grupe është shumë efektive dhe 11% e tyre kanë deklaruar se puna në grupe është disi efektive dhe asnjë përgjigje me aspak efektive. Nga kjo ne kuptojmë se puna në grupe ka shumë ndikim në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lënden e Teknologjisë.

#### 4.4. Rezultati i pyëtësorit drejtuar mësimeve për rastin e hulumtimit

Në pyëtësor kanë marrë pjesë tre mësime nga shkolla të ndryshme


##### 1. Sa zbatohet mësimi me anë të formës së të mësuarit në grupe?



Grafikoni 16. Rezultatet nga pyëtësori me mësimeve pyetja 1

Rezultatet nga grafikoni i radhës na tregojnë se 42% e mësimeve të anketuar kanë thënë se mësimi me anë të formës së të mësuarit në grupe zbatohet shumë, 25% kanë thënë se zbatohet disi dhe 33% e mësimeve kanë thënë se nuk zbatohet aspak.


##### 2. Një grup efektiv sa nxënës mund të përmbajë?



Grafikoni 17. Rezultatet nga pyëtësori me mësimeve pyetja 2

100% e mësimeve të anketuar kanë thënë se një grup efektiv duhet të përmbajë më shumë se tre nxënës që grupi të arrijë efektin e duhur në ngritjen e cilësisë në mësimnxënie.


3. Sa kanë nevojë nxënësit të bashkëpunojnë në grupe për të arritur rezultatet e të nxënit?



Grafikoni 18. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 3

Nxënësit kanë shumë nevojë të bashkëpunojnë në grupe për të arritur rezultate në të nxënë dhe këtë na tregon rezultati i grafikoni ku 100% e mësimdhënësve kanë deklaruar se ka shumë nevojë për bashkëpunim.


4. Cilat nga teknikat i përshtatet më shumë formës së të mësuarit në grupe?



Grafikoni 19. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 4

Teknika që i përshtatet më shumë formës së të mësuarit në grupe sipas 75% e mësimdhënësve të anketuar është Diagrami i Venit dhe me 25% kemi stuhi mendimesh nga përgjigjet e mësimdhënësve të anketuar dhe asnjë përgjigje për tekniken e Kllasterit.


5. Forma e të mësuarit në grupe, sa e motivon nxënësin?



Grafikoni 20. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 5

67% e mësimdhënësve të anketuar kanë thënë se forma e të mësuarit në grupe i motivon nxënësit, 33% e tyre kanë thënë se i motivon disi dhe asnjë përgjigje për aspak.


6. Roli juaj në formën e të mësuarit në grupe?



Grafikoni 21. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 6

Roli në formën e të mësuarit në grupe është bashkëpunues e kanë thënë 67% e mësimdhënësve të anketuar ndërsa 33% e tyre kanë thënë se roli në formën e të mësuarit në grupe është vlerësues.


### 7. Vlerësimi juaj në lidhje me formën e të mësuarit në grupe?



Grafikoni 22. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 7

67% e mësimdhënësve të anketuar kanë deklaruar sipas rezultateve të grafikomit se vlerësimi i tyre në lidhje me formën e të mësuarit në grupe është grumbullim pikësh ndërsa 33% e tyre kanë deklaruar se vlerësimi me notë është forma e të mësuarit në grupe.


### 8. Raportet ndërmjet nxënësve gjatë punës në grupe?



Grafikoni 23. Rezultatet nga pytësori me mësimdhënës pyetja 8

Raportet ndërmjet nxënësve gjatë punës në grupe janë shumë të mira e kanë thënë 100% e mësimdhënësve të anketuar kurse nuk kemi asnjë përgjigje me disi dhe jo i mirë, dhe kjo na bënë të kuptojmë se raportet e mira ndërmjet nxënësve janë një element shumë i rëndësishëm në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lënden e Teknologjisë.


9. Ai trajtoni të gjithë fëmijët njësoj edhe gjatë punës në grupe?



Grafikoni 24. Rezultatet nga pytëtori me mësimdhënës pyetja 9

Rezultatet e grafikoni na tregojnë se 67% e mësimdhënësve të anketuar i trajtojnë të gjithë fëmijët njësoj gjatë punës në grupe dhe 33% mendojnë se disa nga nxënësit meritojnë më shumë dhe nuk i trajtojnë njësoj të gjithë nxënësit ndërsa sa i përket angazhimit të tyre nuk kemi ndonjë përgjigje.

10. Sipas jush sa është mësimi efektiv në formën e të mësuarit në grupe?



Grafikoni 25. Rezultatet nga pytëtori me mësimdhënës pyetja 10

Sa është efektiv mësimi në formën e të mësuarit në grupe kemi rezultatet e radhës ku 67% e mësimdhënësve të anketuar kanë thënë mësimi individual është më cilësor se mësimi individual kurse 33% e tyre mendojnë se mësimi në grupe e ngrit cilësinë në mësim.

## V. ANALIZA DHE DISKUTIMI I TË DHËNAVE

Qëllimi i këtij studimi është që të identifikojmë efektin e punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në shkollën e mesme të ulët në qytetin e Mitrovicës.

Nga rezultatet e nxjerra nga paratesti dhe pastesti për nxënës dhe pytsor për mësimdhënës, në shkollën e mesme të ulët “Abdullah Shabani” në Mitrovicë arrijmë të nxjerrim përfundime për pyetjen hulumtuese: *Sa ka efekt puna në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë?* dhe vërtetimin e hipotezës: *Puna në grupe ka efekte pozitive në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë.*

Nxënësit e përfshirë në hulumtim ishin të klasave të VII-ta. Arsyeja pse është zgjedhur ky nivel shkollimi është që të informohemi se si ndikon puna në grupe në cilësinë e mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në këtë shkollë.

Pasqyra tabelare sipas suksesit të paratestit dhe pastestit i realizuar gjatë këtij hulumtimi me klasat e shtata na ka dhënë këtë rezultat.

### *Paratesti:*

<b>Paralelja</b>	<b>VII/1</b>	<b>VII/2</b>	<b>VII/3</b>
Nota mesatare	2.6	3.6	3.3

Tabela 2. Rezultati i paratestit

### *Pastesti:*

<b>Paralelja</b>	<b>VII/2</b>	<b>VII/3</b>
Nota mesatare	4	3.8

Tabela 3. Rezultati i pastestit

Qëndrimet janë pozitive gjatë aplikimit të punës në grupe dhe ndikimin e saj në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në shkollën që ishte mostër e hulumtimit (Tabela 2). Ngritje të notes mesatare për klasat që kanë aplikuar mësimin në grupe në lëndën e Teknologjisë brenda një periode të notimit mësimor, klasa VII/2 nga 3.60 sa ishte në paratest në 4, në pastest që kemi një ngritje për mesatare të klases (0.40) apo 8.9% në suksesin e përgjithshëm, ndërsa klasa VII/3 nga 3.30 sa ishte në paratest në 3.80, në pastest kemi një ngritje për mesatare të klases (0.50) apo 9.3% në suksesin e përgjithshëm. Viti shkollor tek ne është i ndarë në tri perioda ku secila periode përfshinë dy nota, atëherë në bazë të këtij hulumtimi vijmë me një përfundim se me aplikimin e mësimin në grupe do të kemi ngritje të notes mestare dhe me këtë metodë arrihen rezultate më të mira në procesin mësimor sa i përket mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë, me çka konfirmohet hipoteza e ngritur.

Krahasimi në mes të dhënave sa i përket të nxënit nga rezultati i paratestit dhe pastestit (Tabela 4) kemi një varësi nga metoda e punes në grupe në arritjen e rezultateve në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë.

	<b>Paralelja</b>	<b>VII/2</b>	<b>VII/3</b>
<b>Paratesti</b>	Nota mesatare	3.60	3.30
<b>Pastesti</b>	Nota mesatare	4	3.80
	<b>Diferenca</b>	<b>0.40</b>	<b>0.50</b>

**Tabela 4. Krahasimi i rezultateve**

Nga ana tjetër deklaramet e nxënësve të cilët ishin pjesëmarrës në këtë hulumtim me anë të pyetësorëve rreth 89.3% janë deklaruar se puna në grupe është mjaft efektive në aplikimin e mësimin në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në shkollat e mesme të ulët. Ky fakt tregon rëndësinë e përdorimit të punes në grupe në ngritjen e cilës së mësimnxënies në fusha të ndryshme kurrikulare. Me çka edhe një herë me anë të pyetësorëve konfirmohet hipoteza e ngritur, ku qendrimi i nxënësve është pozitiv.

Poashtu edhe rezultatet e pyetësorëve e të realizuar me mësimdhënës sa i përket efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë rreth 78% (marr nga mesatarja e dhjetë pyetjeve) janë deklaruar pro punes në grupe sepse thonë se ka efekt pozitiv në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies, çka është edhe një hap që e vërteton hipotezen e ngritur.



## **VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

### **6.1. Përfundime nga hulumtimet**

Në këtë kapitull, do të japim një përmbledhje e shkurtër dhe përfundime të nxjerra nga studimi i këtij hulumtimi, anët e mira dhe të dobëta të efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë dhe gjithashtu përfundimet e nxjerra nga implementimi, testimi dhe nga vlerësimi i këtij studimi.

### **6.2. Përfundimet lidhur me efektin e punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në shkollën e mesme të ulët “Abdullah Shabani”**

Komuna e Mitrovicës si të gjitha qytetet e tjera të Kosovës po i kushton vëmendje të veçantë aftësimin të mësimdhënësve sidomos mësimdhënësve të lëndes së Teknologjisë, duke ju krijuar kushte dhe ambient të përshtatshëm për implementimin e ideve inovative në lëndën e Teknologjisë gjithmonë në mbështetje të efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies.

Nga kjo vlen të theksohet se pasi që hulumtimi është realizuar në shkollën fillore të mesme të ulët “Abdullah Shabani” në Mitrovicë, ajo është e paisur me kabinet dhe të gjitha paisjet e nevojshme për ta praktikuar punën në grupe pa ndonjë pengesë. Poashtu edhe mësimdhënësit vlen të theksohet se janë të pregaditur shumë dhe nuk hezitojnë në asnjë moment të ofrojnë nxënësve njohuritë e tyre me qëllim të arritjes së efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë.

### **6.3. Përfundime lidhur me kontributet e implementimeve të efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë**

Puna në grupe, është njëra ndër katër format sociale të punës dhe mendohet se i kontribuon jashtëzakonisht përfitimit të përmbajtjeve për vetë faktin se nxënësit lirshëm bisedojnë me njëri-tjetrin, mund të shkëmbejnë informacione, bisedojnë për dilemat eventuale, të cilat mund të paraqiten gjatë punës në grupe, kur ata punojnë individualisht dhe si rezultat i kësaj efektiviteti është më i madh, arritjet e nxënësve do të jenë më të larta dhe mbi të gjitha format e shoqërorizimit mes anëtarëve të grupit do të jenë më të mëdha, sesa kur punohet vetëm me formën individuale.

Ajo që e fuqizon më tepër aplikimin e kësaj forme, është se duke zhvilluar shkathtësi sociale nxënësit zhvillojnë njohuritë në aspektin kognitiv, shkathtësi të punës në grupe, pra nxënësi përveç që merr njohuri duhet të fitoj edhe shkathtësi të tjera të cilat në rastin tonë të hulumtimit i siguron shkolla.

#### **6.4. Përfundimet në lidhje me paratestin dhe pastestin me nxënësit e klasave VII/2 dhe VII/3**

Në këtë hulumtim nga zhvillimi dhe testimi i efektit të punës në grupe kemi arritur në përfundim se puna në grupe e të mësuarit bën që nxënësit, kur punojnë së bashku janë më të lirë për ta thënë mendimin e tyre gjë që në shkollën tradicionale ka qenë hezitim mos po thuhet diçka gabim, të cilën tani në mesin e bashkëmoshatarëve edhe nëse gabojnë ata arrijnë ti korigjojnë mes veti dhe të përforcojnë informacionin që janë duke e përpunuar. Kjo na dëshmon se në paratest dhe pastest me klasat e shtata, të cilat kanë pasur qasje në punën në grupe gjatë procesit mësimor ka dhënë rezultate pozitive.

Ngritja e suksesit në klasat VII/2 dhe VII/3 sa i përket notës mesatare, në të dy klasat me një diferencë 4 që është e barabartë si në paratest ashtu edhe në pastest, dhe në bazë të saj kemi arritur me një përgjigje pozitive sa i përket hulumtimit që kemi ngritur në këtë punim.

#### **6.5. Përfundimet në lidhje me pytësoret për nxënës**

Nga rezultatet e nxjerra nga dhjetë pyetjet e pytësorit, kam ardhur në përfundim, se përgjigjet janë me një përqindje mbi 86% pozitive sa i përket këtij hulumtimi.

Dhe kemi ardhur në një përfundim se sa është efektive puna në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë, po ashtu e kemi dëshmuar se sa është efektive puna në grupe si në lëndën e Teknologjisë po ashtu do të ishte shumë efektive të aplikohet në të gjitha lëndet e tjera në shkollat fillore të mesme të ulëta.

#### **6.6. Përfundimet në lidhje me pytësoret për mësimdhënës**

Nga rezultatet e nxjerra nga pytësorët ku janë marrë tre mësimdhënës të shkolles fillore të mesme të ulët “Abdullah Shabani” dhe kam ardhur në përfundim se:

- Se puna në grupe e motivon shumë nxënësin.
- Teknika që i përshtatet mësimin në grupe është Diagrami i Venit.
- Nxënësit kanë shumë nevojë të bashkëpunojnë mes vete në grupe për të arritur rezultatet e të nxënës.
- Raporti i nxënësve brenda punës së grupeve është shumë i mirë.

## 6.7. Rekomandime

Për të gjithë mësimdhënësit, trajnerët e drejtuesit e institucioneve arsimore në bashkëpunim me MASHT-së, nga përfundimet e bazuara më sipër, të cilat dëshmojnë se përmes aplikimit të të mësuarit në grupe arrihen njohuri më të larta të nxënësve në lëndët të ndryshme por sidomos në lënden e Teknologjisë, parashtrojmë këto rekomandime:

- Kabinetet e teknologjisë në shkollat tona të furnizohen me pajisje dhe mjete të nevojshme, që mundësojnë zhvillimin e eksperimenteve e demonstrimin e dukurive;
- Krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin e mësimin në lënden e teknologjisë për nxënësit dhe mësimdhënësit;
- Të shpërblej me mirënjohje mësimdhënësit dhe nxënësit nëse kanë arritur ndonjë sukses gjatë punës në grupe.
- Bashkëpunim më të ngushtë të mësimdhënësve me nxënësit, përmes së cilës e vënë nxënësin në rolin e hulumtuesit gjatë punës në grupe;
- Të aplikohet më shpesh forma e punës mësimore në grupe, duke ofruar metoda më tërheqëse me nxënësin në qendër që mundëson nxitjen edhe të nxënësve më pak aktivë.

Edhe pse, disa nga rekomandimet e lartpërmendura janë më se të njohura deri më tani, por nga fakti që janë ndër çështjet që preokupojnë nxënësit dhe mësimdhënësit deri më tani këto probleme nuk janë tejkaluar, vazhdojnë të jenë pjesë e rekomandimeve për institucionet e vendit.

## VII. BIOGRAFIA

- Affin, L. (2018). *Creating an online quiz learning media using* . Indonezi: PGRI.
- Ali, F. (2018). *Use of Google Forms in teaching and assessing english phonology*. Basra: JBRHS.
- Avdiu, E. (2013). *Produktiviteti i mësimnxënies në grupe në përvetësimin e njohurive shkencore në shkencat natyrore*. Tiranë.
- Babaj, N. (2021). *Strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies*.
- Baines, E. (2008). *Promoting Effective Group Work in the Primary Classroom*. Rautledge.
- Baines, E. P, Blatchford.,& P. Kutnick. (2008). *Promoting Effective Group Work in the Primary Classroom*. New York.
- Bebaj, F. (2019). *Efekti i punës me grupe në oren e mësimit*. Prishtinë.
- Boachie, E. (2016). *The effectiveness of Microsoft Exel to improve students continuous assessment in secondary school*. Gana: IJRTD.
- Brody, C., & Nil, D. (2008). *Profesional Development for Cooperative Learning*. New York: SUNY.
- Carrberry, A. (2008). *Learning-by-teaching as a pedagogical approach and its implications on engineering education*.
- Charlotteaux, D. (2009). *Improving Academic Performance Using Cooperative Learning, Instructional Strategies EPI 002*, .
- Dakes, C.Ch. (2005). *Creating a Colloborative Learning Envncironment, Guidebook, Center for the Integradtion of Research, Teaching and Learning*.
- Danellis, W. Ch. (2010). *GroupTheory-Classes, Representation aand Connections, and applications In Mathematics Research Developments* . New York.
- Darren, I. (2017). *Analyzing the efficacy of the testing effect using kahoot on student performance*. USA: TROJDE.

- Education. (2004). *Colaborative learning, Thirteen Ed, Educational Broadcasting Corporation.*
- Frey, N., Fisher, D.&Everlone, S. (2009). *Productive Group Work, How to Engage Students, Build Teanwork, and Promote Understanding.*
- Fulla, M. (2001). *Kuptimi i ri i ndryshimit ne arsim.* Tiranë, SOROS.
- Garner, M., C, Wagner.,& Kaqulich, B. (2009). *Teaching Research Methods in the Social Science.* England: Farnham Surrey.
- Garo, S. (2011). *Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies.* Tiranë: UFO press.
- Gixhari, A. (2016). *Metodat efektive të komunikimit në mësimdhënie.* Tiranë.
- Gjinaj, A. (2018). *Libër mësuesesi Teknologjia 12 me zgjedhje.* Tiranë.
- Gjokutaj, M. Sula. (2009). *Roli i mësuesit dhe stilet e të nxëniet në klasa me në qendër nxënësin.* Tiranë.
- Glassman, U. (2009). *GroupWork: A Humanistic and Skills Building Approach.* L.A: Sage Sourcebooks for the Human Service Series.
- Goode, S. (2014). *The impact of using PowerPoint presentations on student's learning and motivation in secondary school.* Iran: ELSEVIER.
- Henry, Y. (2011). *Using Google Sites to communicate with parents.* Tajlandë: DSIL.
- Hossain, M. (2011). *A web 2.0 based collobarotive model for multicultural education .* Cambridge: EMERALD.
- Ibrahimi, Xh. (2004). *Metodologjia e mësimdhënies dhe të nxëniet aktiv.* Prishtinë; Këshilli Mësimor i SHLP.
- KEC. (2011). *Raporti i punës për vitin 2010.* Prishtinë: Qendra për Arsim e Kosovës.
- Koliqi. (1996). *Vepra I.* Tiranë.
- Kraja, M. (2006). *Pedagogjia .* Tiranë, Tekst Universitar.
- Kryeziu, S. (2012). *Mësuesi dhe mësimdhënia. Format bashkëkohore të organizimit të punës mësimore.* Prishtinë.
- Kurti, A. (2012). *Metodat dhe teknikat e diskutimit dhe punës me grupe.* Tiranë.

- Marzano, R. (2007). *Nastav na strategije*. Zagreb.
- MASHT. (2013). *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë*. Prishtinë.
- MASHT. (2016). *Kurikula bërtham e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës (Klasa VI,VII,VIII dhe IX)*.
- Mexhuani, A. (2014). *Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie*. Prishtinë:IPK.
- Meyer, H. (2002). *Didaktika razredne kvakve*. Zagreb.
- Musai, B. (2003). *Metodologjia e mësimdhënies*. Tiranë: PEGI.
- Nuredini, V. (2012). *Teoria e mësimimit me nxënës-studentin në qendër*. Prishtinë.
- Peshkepia, V. (2012). *Mësimdhënia, mësimnxënia-raportet e tyre me integrimin europian*. Tiranë.
- Ross, M. (2010). *Metodat e hulumtimit*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (QDE).
- Samsudin, S., Das, J., Rai, N&Chij, C. (2013). *Cooperative Learning. heterogeneos Vs Homogenoneous Grouping Singapore*. Singapore.
- Scholnik, M., Kol, S.,& Abarbanel, J. (2006). *Constructivism in Theory and in Practice*.
- Shahini, L & Shahini, J. (2013). *Të mësuarit në shek.XXI, shkolla e vazhdueshme të vazhdueshëm* . Tiranë: IRA press.
- Silver, H.&Perini, M. (2007). *The Strategic Teacher, Seleying the Right Research-based Strategy for Every Lesson*. USA.
- Simo, H. (2007). *The strategic Teacher*. USA.
- Terhart, E. (2002). *Metode poucavanja i ucenja*. Zagreb: Educa.
- UNESCO. (2011). *ICT competency frame work for teachers (ICT CFT). IITE Conference Teacher Competencies in Knowledge Society: Policy, Pedagogy, Social Skills (Baku, Azerbaigian, 1st December 2011)*.
- Vitak, A. (1960). *Problemet themelore të punës në grupe*. Beograd.
- Woo. (2011). *Using a Wii to scffold primary-school student's sollobarotive writing*. Hong Kong: IFETS.

Woolfolk, A. (2011). *Psikologji Edukimi*. Tiranë: CDE.

Zabeli, N. (2006). *Strategjitë të nxënës dhe mësues ndërvetpruese*. Prishtinë.

Zabeli, N. (2010). *Strategji të reja të mësimit*.

Zylfiu, N. (2005). *Aspektet didaktike të organizimit të punës ekipore*. Prishtinë; Pedagogu

## 7.1. SHTOJCA A: Paratesti i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3

Paratesti është hartuar për të nxjerrë rezultate statistikore të efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë. Rezultatet nga ky paratest janë përdorur për qëllime hulumtimi, si dhe një vlerësim të nxënësve për një periudë.

**Emri dhe mbiemri:** \_\_\_\_\_

**Gjinia:** M / F


**Data:** \_\_\_\_\_

**Klasa:** \_\_\_\_\_

1. *Listo së paku 5 burime elektike sipas llojit te ndryshimeve?*
  
2. Si bëhet klasifikimi i burimeve të energjisë elektrike?
  
3. Centralët bërthamore nuk e ndotin mjedisin, por ato paraqesin rrezik për ndotjen e mjedist me substanca radioaktive?
  - a) *Saktë*
  - b) *Pasaktë*
  
4. Cila nga këto përfaqëson një nga burimet më të pastërta dhe më të qëndrueshme të energjisë?
  - a) *Nafta*
  - b) *Thëngjilli (qymyri)*
  - c) *Era*
  
5. Në celulat diellore energjia e rrezeve të diellit shndërrohet drejtpërdrejt në energji elektrike, andaj operimi i tyre është i kufizuar në ditët me diell dhe kur drita është e madhe, kjo nënkupton që nuk mund të gjenerojnë energji gjatë natës dhe kur koha nuk është e mirë.
  - a) *Po*
  - b) *Jo*



6. Bëje një përshkrim të punës së qarkut elektrik (siç shihet në figurën)?



7. Kycjen e paisjeve elektrike në rrjetin elektrik e bëjmë ndërmjet paisjes kyçe e cila quhet?

8. Disa materiale kanë veçori të përçojnë rrymën elektrike, cilat janë këto materiale?

9. Materialet të cilat e përçojnë rrymën elektrike i quajmë \_\_\_\_\_ ndërsa ato materiale të cilat nuk e përçojnë rrymën elektrike i quajmë \_\_\_\_\_.

10. Vizato skemën e qelësit njëpolësh dhe alternativ?

## 7.2. SHTOJCA B: Pastesti i realizuar me nxënës të klasave VII/1, VII/2 dhe VII/3

Pastesti është hartuar për të nxjerrë rezultate statistikore të efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë. Rezultatet nga ky pastest janë përdorur për qëllime hulumtimi, si dhe një vlerësim të nxënësve për një periudë.

**Emri dhe mbiemri:** \_\_\_\_\_



**Gjinia:** M / F

**Data:** \_\_\_\_\_

**Klasa:** \_\_\_\_\_

1. Çka vënë në lëvizje elektromotorët?
2. Elektromotorët janë makina të cilat bëjnë shndërrimin e energjisë mekanike në energji elektrike?  
  
A) Saktë      B) Pasaktë
3. Rrymës të cilës gjithnjë iu ndryshohet kahja e quajmë \_\_\_\_\_, ndërsa rryma që është me intensitet konstant dhe rrejdhet vetëm në një kah e quajmë rrymë \_\_\_\_\_.
4. Rryma e vazhduar rrejdhet vetëm në një kah nga cili pol tek cili?  
  
A) Prej polit pozitiv (+) kah poli negativ (-)  
B) Prej polit negativ (-) kah poli pozitiv (+)
5. Shpenzuesit e ndryshëm të energjisë elektrike që ne i përdorim në jetën e përditshme për punën e tyre cilën rrymë e përdorin?
6. Listoj së paku 3 paisje të cilat përdorin rrymën e vazhduar poashtu 3 paisje rrymën alternative.
7. Funkcionimi i paisjeve dhe makinave të caktuara të cilat drejtohen nga motori elektrik nga kush kontrollohet?

8. Figurat më poshtë paraqesin?



9. Te lidhja paralele e çelësve funksionimi i qarkut tek tabela e gjendjes konstatojmë se:

a) çelësin e mbyllur e shënojmë me \_\_\_\_\_

b) çelësin e hapur e shënojmë me \_\_\_\_\_

10. Elektromotorin aktiv e shënojmë me “1” ndërsa atë që nuk është në punë me “0”.

a) Saktë      b) Pasaktë

### **7.3. SHTOJCA C: PYETËSORI PËR NXËNËS TË KLASAVE VII/1, VII/2 DHE VII/3**

Tema: Efekti i punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lënden e Teknologjisë

Shkolla: “Avdullah Shabani” Mitrovicë

Mosha: \_\_\_\_\_

Gjinia: M / F

Klasa: VII

Ky pyetësor është hartuar për të nxjerr rezultate statistikore për përdorimin e efektit të punës në ngritjen e cilësisë së mesimnxënies në lënden e Teknologjisë! Rezultatet nga ky pyetësor janë përdorur për qëllime hulumtimi dhe studimi, në asnjë mënyrë për qëllime të tjera.

Udhëzime; Secila pyetje, ka më poshtë opsione me alternativa. Rrumbullakësoni opinionin i cili ju duket më i arsyeshëm. Ju lutem të jeni sa më objektiv në qendrimin tuaj.

***Ju faleminderit!***

#### **11. Sa realizohet puna ne grupe gjatë një ore mësimore?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

#### **12. Si e bën mësimdhënësi ndarjen e grupit?**

- Sipas dëshires
- Zgjedh më aktivët në grup
- Në secilin grupzgjedh një nxënës me më shumë njohuri

#### **13. Sa ju përgadit mësimdhënësi për një temë të caktuar?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

#### **14. Si i keni raportet ju si nxënës mes vete gjatë punës në grupe?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

**15. Sa ndikon ne përvetësimin e njohurive forma e të nxënit/ në grupe?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

**16. Sa vërehen rezultatet nga të mësuarit në grupe?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

**17. Sa ju motivon kjo formë e të nxënit në grupe?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

**18. Si vlerësoheni nga mësuesi për aktivitetin tuaj?**

- Në mënyrë individuale
- Vetëm përfaqësuesi i grupit
- Vlerësohet si grup

**19. Sa jeni të kënaqur me punën e mësuesit dhe angazhimin e tyre gjatë punës në grupe?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

**20. Sa efektive është puna në grupe?**

- Aspak
- Disi
- Shumë

## 7.4. SHTOJCA D: PYTËSORI PËR MËSIMDHËNËS

Pytësori që ju keni në dorë shërben për të studiuar efektshmërinë e efektit të punës në grupe në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies në lënden e Teknologjisë në shkollat e mesme të larta.

Përgjigjet tuaja në këtë pyetësor regjistrohen direkt në një bazë të dhënash dhe do të trajtohen si tërësisht konfidenciale. Pytësori do të plotësohet në mënyrë anonime (duke mos specifikuar emrin tuaj) në mënyrë që të ruajmë konfidencialitetin e të dhënave që ju do të afroni.

Udhëzimet: Secila pyetje, ka më poshtë opsione me alternativa. Rrombullakësoni opsionin i cili ju duket më i arsyeshëm. Ju lutem të jeni sa më objektiv në qendrimin tuaj.

*Ju faleminderit!*

### 1. Sa zbatohet mësimi me anë të formës së të mësuarit në grupe?

- Aspak
- Disi
- Shumë

### 2. Një grup efektiv sa nxënës mund të përmbajë?

- Dy nxënës
- Tre nxënës
- Më shumë se tre nxënës

### 3. Sa kanë nevojë nxënësit të bashkëpunojnë në grupe për të arritur rezultatet e të nxënës?

- Aspak
- Disi
- Shumë

### 4. Cilat nga teknikat i përshtatet më shumë formës së të mësuarit në grupe?

- Kllaster
- Stuhi mendimesh
- Diagrami i Venit

### 5. Forma e të mësuarit në grupe, sa e motivon nxënësin?

- Aspak
- Disi
- Shumë

**6. Roli juaj në formën e të mësuarit në grupe?**

- Bashkëpunues
- Mbikqyrës
- Vlerësues

**7. Vlerësimi juaj në lidhje me formën e të mësuarit në grupe?**

- Grumbullim pikësh
- Vlerësim me notë
- Nxitje në mësim

**8. Raportet ndërmjet nxënësve gjatë punës në grupe?**

- Jo i mirë
- Disi i mirë
- I mirë

**9. Ai trajtoni të gjithë fëmijët njësoj edhe gjatë punës në grupe?**

- Varet nga angazhimi i tyre
- Disa meritojnë më shumë
- Po

**10. Sipas jush sa është mësimi efektiv në formën e të mësuarit në grupe?**

- Nuk tregon rezultate të mira
- Ngrit cilësinë në mësim
- Mësimi individual më cilësor